

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”

Universiteti i New York-ut në Tiranë

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Klodiana Gorica

Prof. Asoc. Dr. Ana Kapaj

Mars, 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit "Master i shkencave" në "Financë dhe kontabilitet"

| Tabela e të dhënave për programin e studimit | | |
|--|---|--|
| 1 | IAL Aplikues: | Universiteti i New York-ut në Tiranë |
| 2 | Fakulteti që e ofron | Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit/ Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës |
| 3 | Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit | VKM Nr. 939, datë 03.09.2009 |
| 4 | Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë | UMASH Nr. 286, datë 05.07.2013/ VKA Nr. 490, datë 03.06.2013 |
| 5 | Titulli i programit të studimit: | Master i shkencave në "Financë dhe kontabilitet" |
| 6 | Cikli i studimit: | Cikli i dytë |
| 7 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vite akademike |
| 8 | Kreditet në total (ECTS): | 120 ECTS |
| 9 | Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/): | Me kohë të plotë |
| 10 | Gjuha (shqip/tjetër): | Anglisht |
| 11 | Programi ofrohet nga institucioni | Po |
| 12 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera | Jo |
| 13 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | Jo |
| 14 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | Jo |
| 15 | Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve | Niveli 7 |
| 16 | Numri i studentëve | 18 studentë |

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” u licencua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 939, datë 03.09.2009 si program studimi i ciklit të dytë, në përfundim të të cilit lëshohet “Diplome e Nivelit të Dytë”, sipas terminologjise se Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Në zbatim të Nenit 99/3 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, ky program studimi është përshtatur në programin “Master Shkencor” që realizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale 2-vjet, konfirmuar me shkresë nr. 6858/2 prot., datë 06.05.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 286, datë 25.07.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me Vendimin Nr. 490, datë 03.06.2013 të Këshillit të Akreditimit. Ky program ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, përkatesisht nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës brenda këtij fakulteti në Universitetin e New York-ut në Tiranë (UNYT).

UNYT është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 397, datë 15.08.2002 “Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare, Jopublike, “New York University – Tirana”. Përgjatë viteve, ky institucion ka pësuar ndryshime, ku më të rëndësishmet janë: ndryshimi i statusit nga Shkollë e Lartë Universitare në **Universitet**, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 448, datë 11.07.2012; si dhe ndryshimet në strukturën akademike. Së fundmi, institucioni është riorganizuar me Urdhër Nr. 288, datë 22.05.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Universiteti ka kaluar disa procese të akreditimit institucional dhe aktualisht gëzon statusin “**i akredituar institucionalisht**”, sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 102, datë 10.11.2017. Ky vendim u finalizua pas procesit të riakreditimit institucional të realizuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në kuadrin e bashkëpunimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar (QAA).

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm Periodik (më poshtë do të quhet Raporti) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”, ofruar nga Universiteti i New York-ut në Tiranë. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, sipas shkresës nr. 326/2018, datë 16.11.2018 të UNYT, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitave në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë në kuadër të tyre.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën: Prof. Dr. Klodjana Gorica dhe Prof.Asoc.Dr. Ana Kapaj si eksperte të jashtme vlerësimi për këtë program studimi.

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga Koordinatorët Teknike të ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku dhe Znj. Emisa Isufaj.

Universiteti i New York-ut në Tiranë është njohur me Draft- Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 19.03.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 35/23 Prot., datë 19.03.2019. UNYT përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 111/2019 Prot., datë 21.03.2019 komentet

në lidhje me Draft- Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Ekspertet e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:

- Për informacionin si vijon në paragrafin e shkresës “*Në vijim të shqyrtimit të draft raportit, dëshirojmë të vemë në dukje se universiteti në mënyrë të vazhdueshme është angazhuar në rekrutimin e stafit të brendshëm në fushën e financës dhe kontabilitetit duke bërë thirrje për vendet vakante si për staf lokal ashtu edhe për atë ndërkombëtar. Universiteti mban një qëndrim të qartë në mbulimin e programit në masën 70% nga stafi akademik efektiv, siç edhe vihet re duke filluar nga viti akademik 2016 e në vijim. Për vitin akademik 2018-2019, ju informojmë se mbulimi i programit nga stafi akademik efektiv është në masën 70%, duke marrë parasysh zgjedhjen e lëndëve elektive nga studentët në muajin Shkurt. Këto lëndë nuk ishin zgjedhur ende në kohën e raportimit në funksion të riakreditimit të programit.*”, GVJ vlerëson maksimalisht përpjekjet e UNYT për angazhimin e tij në respektimin e raporteve PAE/PAK në përputhje me standartet në fuqi. Raportimi nga ana e GVJ (faqe 14 RVJ), është bazuar në të dhënat e mara nga vetë IAL (Tabela 4 dhe 4.1 në Aneksë). Argumentimi i GVJ është në përputhje me vetë IAL për vitet 2013-2016. Ndërkohë që siç e ka konstatuar edhe GVJ për vitin 2016-2017 dhe 2017-2018 ky raport është në nivelin 70% (faqe 14 RVJ). Për vitin 2018-2019, arsyetimi i GVJ është bazuar totalisht në të dhënat e mara nga IAL dhe nga këto të dhëna rezultojnë se mbulimi i lëndëve me PAE është në masën 66.7%. Ndërkohë GVJ është koshient se viti akademik 2018-2019 është akoma në vazhdim, dhe kur të bëhet finalizimi i ngarkesave faktike gjëndja mund të rezultojë sic argumenton IAL. Megjithatë GVJ mbetet në reflektimin aktual të të dhënave. Bazuar në arsyetimet e mësipërme, **GVJ është i mendimit të mos e ndryshojë raportin në këtë pikë.**
- Për komentin e institucionit “*Në lidhje me rekomandimin për përmirësimin e nivelit të kontigjentit të studentëve (fq. 4, pika c), gjykojmë se rekomandimi është përmbushur plotësisht, pasi institucioni i përmbahet plotësisht kërkesës ligjore për një mesatare minimale 6.5. Mesatarja pas akreditimit të parë varion nga 7.74-8.13, e cila tejkalon kriterin ligjor dhe mund të konsiderohet si një mesatare e lartë, duke marrë parasysh vështirësinë e fushës së studimit dhe nivelin e programit. Trendi ndër vite tregon se mesatarja është afër notës 8.*”, GVJ vlerëson maksimalisht përpjekjet e UNYT për angazhimin e tij në përmirësimin e kontigjentit të studentëve. Ajo çka konstaton GVJ nga të dhënat e mara në IAL është se nota mesatare në vitin e fundit 2018-2019 ka patur një rënie të lehtë në 7.74. Në gjykimin e përgjithshëm për përmbushjen e rekomandimit të lënë nga KA, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është shprehur se mesatarja e studentëve në hyrje është e mirë. (faqe 5, RVJ) **GVJ i qëndron konkluzionit të dhënë dhe Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.**
- Për komentin e institucionit “*Në vijim të rekomandimeve të bëra për kërkimin shkencor, dëshirojmë t’ju vemë në dijeni se Universiteti ka ndërmarrë iniciativa për organizimin e dy konferencave ndërkombëtare shkencore në shkencat e aplikuara (<http://icfas2019.intsa.org/index.html>) dhe në shkencat sociale dhe një konferencë studentore.*”. GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit në këtë drejtim si dhe iniciativën e tij për organizimin e dy konferencave ndërkombëtare shkencore në shkencat e aplikuara. Gjykimi apo vlerësimi apo konkluzioni i dhënë është bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit nga akreditimi i parë në vitin 2013 deri në dokumentacionin e vënë në dispozicion pas vizitës. Për këtë arsye **GVJ konkludon se Raporti nuk ndryshon.**

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Të bëhet më shumë përpjekje për të rritur numrin e regjistrimeve të studentëve në këtë program studimi
- b) Të krijohen terrene sportive
- c) Të përmirësohet niveli i kontigjentit të studentëve
- d) Të shihet mundësia për të ulur tarifën e shkollimit për këtë program studimi

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin “Të bëhet më shumë përpjekje për të rritur numrin e regjistrimeve të studentëve në këtë program studimi”, institucioni ka parë me prioritet të veçantë mundësinë për rritjen e numrit të studentëve që ndjekin këtë program studimesh. Ky fokus i rritur në këtë drejtim vihet re në vetë politikat e promovimit që i bën kjo IAL programit të studimeve “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”. Gjithashtu kjo IAL ndjek dhe politika të mira lidhur me reduktimin e bursave për studentët që vazhdojnë këtë program studimesh.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur.

- b) Për rekomandimin “Të krijohen terrene sportive”, institucioni ka marë masa dhe që prej vitit 2014 janë transferuar një në hapësirë më të gjerë, ku studentët kanë mundësi dhe për terrene sportive.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur.

- c) Për rekomandimin “Të përmirësohet niveli i kontigjentit të studentëve”, institucioni ka marë masa lidhur me kriteret hyrëse në këtë program studimesh në “Financë dhe kontabilitet”. Është vendosur me vendim Senati, niveli B1/B2 i anglishtes si dhe nota mesatare 6.5. Megjithatë këto kriteret përcaktohen nga institucioni si jo përjashtuese. Duke iu referuar të dhënave të mara nga UNYT lidhur me notën hyrëse të studentëve, ajo varion nga 7.74-8.13 për vitet 2013-2019. GVJ vlerëson se kjo notë mesatare hyrëse është e një niveli mesatar të pranueshëm për këtë nivel studimesh. Megjithatë nuk vihet re një rritje e notës mesatare në vite, madje mund të themi se për vitin e fundit akademik 2018-2019 nota mesatare hyrëse e studentëve është më e ulëta në vite, 7.74.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur pjesërisht.

- d) Për rekomandimin “Të shihet mundësia për të ulur tarifën e shkollimit për këtë program studimi”, institucioni ka ndjekur politikën e dhënies së bursave për studentët bazuar në kriteret të ndryshme si nota mesatare, mundësitë e kufizuara financiare të studentëve, përkatësia e grupeve problematike social-ekonomike, etj.

GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Mbështetur në dokumentacionin e sjellë në Dosjen e vetëvlerësimit nga UNYT (DVV), Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se: Misioni i UNYT është përgatitja e udhëheqësve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar.

Programi “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” është ndërtuar në mënyrë të tillë që t’i pajisë studentët me njohuri të avancuara në tematika të profilizuara të financës dhe kontabilitetit. Kjo mundëson studentet të përfshihen në punësime në sektorin e financës dhe të kontabilitetit. Programi “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” synon të thellojë njohuritë dhe të japë një përjasje të plotë teorike duke kombinuar këto njohuri me praktika të orientuara nga kërkimi shkencor, me qëllim ndihmën dhe mbështetjen tek studentet për të vijuar studimet e tyre në programet doktorale. Programi “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” reflekton dhe zbaton misionin dhe qëllimin e institucionit.

Objektivat kryesore të këtij programi studimi lidhen dhe referohen kryesisht me:

- Të mundësojë ofrimin e njohurive bazike themelore për studentët që vijnë nga financa dhe kontabiliteti ashtu edhe nga degë të tjera;
- T’ju mundësojë studentëve njohjen dhe zbatimin e mjeteve të nevojshme, si dhe gjerësinë dhe thellësinë e disiplinës për të vijuar në nivelet e tjera të studimit në financë dhe kontabilitet;
- T’i njohë dhe aftësojë studentët me mjetet, konceptet dhe metodologjinë e duhur për punë kërkimore të pavarur dhe t’i drejtojë studentët në etapa të ndryshme të procesit;
- Të kuptuarit e plotë të detajeve teknike dhe të kornizës konceptuale të brendashkruar të disiplinave studimore të financës, kontabilitetit financiar dhe atij administrativ;
- Të vlerësojë në mënyrë kritike dhe bashkëkohore kërkimin shkencor në fushat e mësipërme;
- Të shfaqë një kuptim themelor të metodave sasiore dhe cilësore të përshtatshme për të studiuar dhe zbatuar në këtë fushë;
- Të vlerësojë dhe njohë strukturën aktuale të industrisë së financës dhe kontabilitetit si dhe rëndësinë e programit të tyre të studimit në të ardhmen e karrierës së tyre;
- Të shqyrtojë në mënyrë kritike fushat e specialitetit përmes mundësisë së përzgjedhjes;
- T’ju mundësojë studentëve trajnime praktike dhe konkrete të orinetuara nga certifikatat profesionale që do të jenë të vlefshme për karrierën e tyre në këtë industri.

Për të realizuar mësimdhënie cilësore, institucioni përpiket të përmirësojë standardet e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, nëpërmjet përditësimit të tematikave në përputhje me zhvillimet më të fundit, në disiplinat përkatëse. Për këtë qëllim janë ndërtuar disa dokumenta strategjikë, si Strategjia e Kërkimit 2014-2017 dhe Plani Strategjik 2018-2022, strategji kërkimi që përcaktojnë shtyllat dhe prioritetet kryesore strategjike të kërkimit në të ardhmen, strategji të vecanta të ndërkombëtarizimit, etj.

UNYT investon në rritjen e kapaciteteve dhe intensitetit të kërkimit. UNYT mbështet kërkimin shkencor ndërdisiplinor ndërmjet të gjithë njësive bazë, departamenteve e qendrave kërkimore, si edhe në partneritet me institucione të tjera. Aktivitetet dhe produktet kërkimore synojnë jo vetëm të rrisin ndikimin në shkëmbimin e njohurive në komunitetin shkencor por edhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik social të vendit përmes trajtimit të problematikave me zgjidhje krijuese e rekomandime të qarta. Në funksion të politikave të kërkimit shkencor në UNYT, ruajtja e integritetit, barazia dhe diversiteti mes stafit dhe studentëve të përfshirë në kërkim, janë thelbësore.

Metodologjia e përdorur në këtë vlerësim ndihmoi në konstatimin se UNYT është i angazhuar në zhvillimin intelektual, krijues dhe individual të studentëve të tij. Në kuadër të këtij angazhimi dhe në përputhje me misionin dhe objektivat e tij, Programi Master shkencor në finance dhe kontabilitet udhëhiqet nga strategjia afatgjatë e ofrimit të njohurive të qëndrueshme.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| <p>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p> | <p>Grupi i vlerësimit të jashtëm konstatoi përmes konsultimeve me të gjithë dokumentacionin e vene në dispozicion (rregulloret baze, dokumentat strategjike ekzistues dhe të perdituesuar), dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit të UNYT se programi i studimit është ngritur mbi misionet dhe objektivat e përcaktuara në “Strategjinë e zhvillimit të programit”.</p> <p>Pasja e nje plani strategjik 2018-2022 perben nje pike te forte, mbeshtetese dhe orientuese. Ne kohe UNYT ka hartuar dy plane strategjike 2013-2017, dhe 2018-2022. Ne planin e dyte vendosen disa prioritete midis te cilave jane studentet, kerkimi dhe mesimdhënia. Plani 2 strategjik perben nje plan konkret te ndertuar mbi mangesite dhe mosrealizimet e planit te pare, ate te para 2017, dhe perben nje pike te forte orientuese per te ardhmen. Megjithese sugjerohet pasja e nje dokumenti qe perfshin studimin e tregut, GVJ rezulton se ky dokument nuk permban nje studim te mirefillte tregu, mbi te cilin te argumentojte programin, kurrikulat, etj. Drejtuesit e programit kane ndermarre takime me drejtues te institucioneve financiare dhe mbi kete baze argumentojne nevojën qe ka tregu vendas per kete program studimi, por universiteti duhet te hartoje nje kerkim i mirefillte tregu, mbi bazat e se ciles te vendosen vertet orientimi mbi ato profile apo dege qe i kerkon tregu shqiptar dhe nevojat e biznesit vendas. Nje kerkim i mirefillte tregu do te perafroje shume me mire orientimet nderkombetare me nevojat kombetare per kete program studimi. Ne kete menyre do te perafroje dhe permbushe me mire ato nevoja qe vertet ka zhvillimi i ekonomise vendase. Megjithate ky program eshte pershtatur, bazuar ne intervistat e kryera nga drejtuesit e programit, me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe te interesit kombetar, si dhe reflekton vullnetin e UNYT per t’iu permbushur e permbajtur vlerave te kombit shqiptar.</p> |
| <p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> | |

| | |
|--|---|
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> | <p>Bazuar ne dokumenta strategjike (Plani Strategjik, 2012-2017, 2018 – 2022, rregullorja e Programeve ne Anglisht UNYT, korrik 2014) por edhe nga takimet ne terren me ekipe te ndryshme te perfaqesive te UNYT, rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Organizimi i programit të studimit është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin, qëllimin, metodat, dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. • Programet e studimeve të ofruara në UNYT janë në përputhje me planin strategjik për zhvillim të UNYT dhe synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë por edhe formimin e shprehive profesionale, si edhe me metodologjitë shkencore të përgjithshme. • Nga takimet në institucione me drejtuesit e njësive kryesore, strategjia e zhvillimit në të ardhmen, do të mbështesë politikat e orientimit të studentëve. <p>Dokumentacioni kryesor që mbështet përputhshmërinë e programeve me strategjitë për zhvillim të institucionit janë: Aneksat përkatëse të Planit Strategjik UNYT 2012-2017 dhe Strategic Plan UNYT 2018-2022; Rregullorja e programeve Anglisht.</p> |
| <p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> | <p>Programi i studimit eshte ne perputhje me legjislacionin dhe aktet nenligjore apo rregulloret ne fuqi. Emertesa e ketij programi – Master i shkencave në “Finance dhe kontabilitet” eshte ne perputhje me nivelin e kualifikimit te arritur dhe te percaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p> |
| <p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p> | <p>UNYT ka nje plan strategjik ne nivel institucional per zhvillimin dhe permirsimin e programeve te studimit. Pasja e nje plani strategjik 2018-2022 perben nje pike te forte, mbeshtetese dhe orientuese. Ne kohe UNYT ka hartuar dy plane strategjike 2013-2017, dhe 2018-2022. Ne planin e dyte vendosen disa prioritete midis te cilave jane studentet, kerkimi dhe mesimdhenia. Plani 2 strategjik perben nje plan konkret te ndertuar mbi mangesite dhe mosrealizimet e planit te pare, ate te para 2017, dhe perben nje pike te forte orientuese per te ardhmen.</p> |

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ gjykon se UNYT ka ndërtuar një praktikë pozitive dhe të qëndrueshme për funksionimin, realizimin dhe përputhshmërinë e qëllimeve dhe objektivave të studimit me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, me strategjitë dhe ndjekjen e realizueshmërisë së tyre e të gjithë hallkave të procesit, duke bërë që realizimi apo problemet që mund të hasen në një hallkë të ndikojnë në etapat e tjera si dhe në të gjithë procesin.

Qe nga 2018 UNYT ka vendosur nje *orientim strategjik te qarte* te shpresur permes objektivave 2018-2022 ne funksion te misionit fillestar. *Qartesia e ketyre objektivave* e shprehur permes te gjithe dokumentave strategjike te perditesuar perben *pike te forte* me shume per te ardhmen, sepse qarteson prioritetet strategjike qe do te kene rendesi per UNYT. UNYT mundohet te optimizojë maredheniet me institucionet nderkombetare dhe kombetare me qellim permiresimin e mesimdhënies, rritjen e nivelit te kerkimit shkencor, perfshirjen e studenteve, etj, objektiva keto qe jane te specifikuara si objektiva strategjike per te ardhmen ne te gjitha dokumentat strategjike. Qartesia e ketyre objektivave e materializuar ne dokumenta te miratuara nga vete UNYT do te sherbeje si nje guide e qarte dhe orientuese per te ardhmen.

GVJ gjykon se standarti plotësohet, por per te patur nje perputhshmeri te nevojës per kete program studimi me ate cka kerkon tregu shqiptar, si dhe per te mbështetur me mire dhe me shume ekonomine vendase ne ato dege qe vertet kane rendesi, prioritet por edhe me shume nevojë per programe te tilla studimi, sugjerohet qe UNYT te mos mjaftohet dhe konsideroje vetem intervistat me drejtuesit kryesore te disa institucioneve kombetare, por pervecse te zgjeroje listen e bizneseve shqiptare qe marrin pjese na panaire, te ndermarre nje kerkim tregu per te siguruar nevojën e ofrimit te ketij programi studimi ne te ardhmen.

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Piesa përshkrimore

Mbështetur në statutin e UNYT si dhe në përpudhje me Ligjin e arsimit të Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi, ky institucion i arsimit të Lartë është i organizuar në 3 njësi kryesore. Këto njësi janë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe Fakulteti i Informatikës. Secila nga këto njësi ka në përbërje të saj 3 njësi bazë, nga 2 Departamente dhe 1 Qendër Kërkimore.

Ndërkohë njësitë administrative mbështetëse në funksion të mirëfunksionimit të këtij institucioni në përputhje edhe me Statutin e tij janë, Zyra e financës, Sekretariati mësimor, Zyra e pranimit të studentëve, Zyra e marketingut dhe Mardhënieve me publikun, Zyra e Burimeve Njërëzore, Zyra e Menaxhimit të Shërbimeve, Zyra e Projekteve, Zyra e koordinimit, Biblioteka, Zyra e Karrierës dhe Cështjeve Studentore, Zyra e Mardhënieve me Jashtë.

Përvec njërive të përshkruara më sipër, janë edhe 3 Qendra ndihmës akademike, Qendra e Matematikës, Qendra e Shkrimit Teknik, Qendra e Këshillimit dhe Mbështetjes Akademike.

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” zhvillohet pranë Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, në UNYT. Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe aktet ligjore në fuqi, ky Fakultet organizohet në tre njësi bazë që janë:

1. Departamenti i Administrim Biznesit;
2. Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës;
3. Qendra kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin.

Në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, secila prej njërive bazë ka në përbërje të saj të paktën 7 pedagogë efektiv. Përvec stafit pedagogjik me kohë të plotë, për të plotësuar nevojat e këtij programi

studimesh, UNYT angazhon edhe staf pedagogjik të ftuar. Gjithsej FEB, për vitin akademik 2018-2019 ka **21 staf akademik efektiv (PAE)** dhe **5 staf akademik me kontratë (PAK)**.

Kualifikimi i stafit akademik efektiv (PAE), për vitin 2018-2019 është:

1 Prof.Dr., 3 Prof.Asoc.Dr., 8 Dr. dhe 9 Msc.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Struktura akademike e Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, për vitin akademik 2018-2019 jepet si më poshtë:

| Departamenti | Përbërja |
|--|--|
| Departamenti i Administrim Biznesit | 7 pedagogë efektiv (PAE) , nga të cilët: 1 Prof.Asoc.Dr, 3 “Doktor”, 3 Master Shkencor; si edhe 2 pedagogë me kontratë (PAK) |
| Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës | 7 pedagogë efektiv (PAE) , nga të cilët: 1 Prof. Dr., 2 Prof.Asoc.Dr., 2 “Doktor”, 2 Master Shkencor; si edhe 3 pedagogë me kontratë (PAK) |
| Qendra kërkimore për Ekonominë dhe Biznesin. | 7 pedagogë efektiv (PAE) , nga të cilët: 3 “Doktor”, 4 Master Shkencor. |

Në mënyrë më të detajuar të dhënat lidhur me listën emërore të stafit të shpërndarë sipas të 3 departamenteve, titujt dhe gradat e tyre, PAE ose PAK, jepen në Tabelën 1 dhe Tabelen 2 në Anekse.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit përbëhet nga tre anëtarë (1 Prof.Asoc. Dr., dhe 2 Doktor), Tabela 3 në Anekse.

Në funksionet e saj FEB mbështetet dhe bashkëpunon me njësitë ndihmëse dhe administrative të UNYT, të cilat paraqiten si më poshtë:

- Njësitë ndihmëse të UNYT si: Zyra e financës, Zyra e sekretarisë mësimore, Zyra e pranimit të studentëve, Zyra e burimeve njerëzore, Zyra e Marrëdhënieve me jashtë; Zyra marketingut dhe Marrëdhënieve me publikun; Zyra e Njesisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC);
- Njësitë ndihmëse akademike të UNYT; Qendra e Matematikës, Qendra e shkrimit teknik, Qendra e këshillimit dhe mbështetjes akademike

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Të dhënat e datajuara lidhur me stafin, emrat, gradat, ne vite (2013-2019) jepen të detajuara në Tabelën 1 dhe Tabele 2 në Anekse.

GVJ analizoi të dhënat për stafin e njësive bazë, që janë përgjegjëse për programin e studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”. Mbështetur mbi të dhënat e siguruar në RVB dhe gjatë vizitës në institucion nuk u vunë re ndryshime në informacion e përcjellë nga RVB.

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|-----------------------------|
| Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për | |

përbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.

Struktura organizative e UNYT mbështet plotësimin e misionit të institucionit.

UNYT në përbërje të tij ka 3 Fakultete, Fakulteti Ekonomise dhe Biznesit, Fakulteti i Informatikës dhe Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave sociale. Programi i studimeve “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” ofrohet nga Fakulteti Ekonomise dhe Biznesit.

Çdo fakultet është i organizuar në njësi bazë. Fakulteti Ekonomisë dhe Biznesit që mbulon edhe programin e studimeve, është i organizuar në 2 Departamente dhe Qëndër Kërkimore.

GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit, i RVB, si dhe vizitës në institucion vlerëson se, personeli akademik i tre njësive bazë të Fakultet Ekonomisë dhe Biznesit, i përgjigjet kërkesave ligjore. Referuar informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion (Tabela 1, 2, në Aneksë), në përbërje të **Departamentit të Ekonomiksit dhe Financës** që është përgjegjës për këtë program studimi Master, per vitin **2017-2018 ka 7 anëtarë si personel akademik efektiv**, prej të cilëve **3 të kategorisë “Profesor”, 2 me gradën “Doktor” dhe 2 “Master i Shkencave” dhe 7 anëtarë PAK**, ndër të cilët **2 i kategorisë profesor, 1 mban gradën doktor dhe 4 MSc.**

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Nga vizita në institucion dhe informacioni i siguruar nga takimet me drejtues të njësisë kryesore dhe njësisë bazë, rezulton se këto struktura janë të ndërgjegjshme për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”. Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë dhe Biznesit, realizohet duke u mbështetur në aktet rregullative të UNYT (*Statuti, RVB*).

GVJ konstaton nga informacioni i siguruar në takimin me përgjegjësen e departamentit si dhe me përfaqësuesen e zyrës së Burimeve Njerëzore, se njësia bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm. Departamenti propozon profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me ngarkesën mësimore që duhet të plotësohet. Gjithashtu sipas intervistave me drejtues të fakultetit dhe departamentit, por edhe nga RVB, një nga komponentët e vlerësimit të performancës së personelit akademik të departamentit, është edhe

vlerësimi i përgjegjësit të departamentit. Kjo përfshin kryesisht korrektesën e tij në respektimin e orarit të punës, zhvillimin e mësimit, dhe përmbushjen e detyrimeve të tjera akademike, si edhe cilësinë e mësimdhënies në auditor. (Aneksi 7.1 RVB, Takimi me titullarët)

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se:

- UNYT organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij
- Struktura organizative e UNYT mbështet plotësimin e misionit të institucionit
- UNYT në përbërje të tij ka 3 Fakultete, Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit mbulon programin e studimeve dhe është i organizuar në 2 departamente dhe 1 Qëndër kërkimore
- Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve. Njësia kryesore dhe bazë, përgjegjëse për këtë program studimesh, janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programit të studimit dhe përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Stafi i Universitetit të Neë York-ut Tiranë përbëhet nga: Personeli akademik (efektiv dhe me kontratë) dhe Personeli administrativ.

Sipas RVB, stafi akademik kategorizohet në:

- Rektori
- Dekanët e tre fakulteteve (Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, Fakulteti i Informatikës dhe Fakulteti dhe i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale) dhe Drejtorët e qendrave
- Përgjegjësat e departamenteve (2 departamente FEB, 2 departamente FI dhe 2 departamente FDS)
- Stafi akademik në departamente (me nga 7 pedagog efektiv çdo departament, konform kërkesave ligjore në fuqi)

Personeli akademik, në UNYT sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen, kategorizohet sipas kategorive, të përcaktuara në ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor", profesorë, lektorë dhe asistent lektorë. Funkcionet kryesore të personelit akademik janë veprimtaria mësimore, konsultim për studentët, kërkim shkencor, kontribut për institucionin. Ngarkesa për personelin akademik është në përputhje të plotë me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë *Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se stafi i brëndshëm akademik i UNYT është i angazhuar edhe në funksione administrative. Kjo gjë mund të rëndojë punën e tyre të përditshme dhe GVJ, sygjeron një lehtësim të stafit nga punët e tjera administrative.*

Për vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **6 personel akademik efektiv (PAE)**, nga ku 5 janë me tituj/grada, dhe **3 personel akademik me kontratë (PAK)** ku të gjithë janë me tituj/grada. (Tabela 4 në Anekse)

Nga konstatime e realizuara gjatë vizitës në institucion u vu re një stabilitet e stafit akademik të angazhuar në këtë program në masën 70%.

Referuar të dhënave në Tab. 8.2:

Për 2013-2014, ngarkesa mësimore (mbi baze kreditesh) që mbulon PAK është 48; PAE është 72

Për 2014-2015, ngarkesa mësimore (mbi baze kreditesh) që mbulon PAK është 40; PAE është 80

Për 2015-2016, ngarkesa mësimore (mbi baze kreditesh) që mbulon PAK është 32; PAE është 88

Për 2016-2017, ngarkesa mësimore (mbi baze kreditesh) që mbulon PAK është 28; PAE është 92

Për 2017-2018*, ngarkesa mësimore (mbi baze kreditesh) që mbulon PAK është 16; PAE është 96

Për 2018-2019*, ngarkesa mësimore (mbi baze kreditesh) që mbulon PAK është 32; PAE është 64.

Në një vit akademik ofrohen lëndë për dy kohorta, ndaj lëndët me () sikurse sqarohet me shënimet poshtë tabelave i përkasin kohortave të mëparshme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhënat lidhur me numrin i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, jepen në Tabelat 4, 4.1 në Aneks.

Për vitin akademik 2018-2019 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 9, nga ku 6 personel akademik efektiv (PAE), dhe 8 janë më tituj/grada. Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 10, nga ku 7 personel akademik efektiv (PAE), dhe 8 janë më tituj/grada. Për vitin akademik 2016-2017 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 10, nga ku 7 personel akademik efektiv (PAE), dhe 8 janë më tituj/grada. Për vitin akademik 2015-2016 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 11, nga ku 7 personel akademik efektiv (PAE), dhe gjithsej 9 janë më tituj/grada. Për vitin akademik 2014-2015 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 10, nga ku 5 personel akademik efektiv (PAE). Gjithsej janë 8 staf më tituj/grada. Për vitin akademik 2013-2014 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 9, nga ku 5 personel akademik efektiv (PAE) dhe 4 PAK. Gjithsej janë 5 staf më tituj/grada. (Tabela 4 në Aneks)

GVJ konstaton se kualifikimi i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi është i përshtatshëm. Një pjesë e mirë e stafit mban gradën Doktor dhe një pjesë tjetër është e kategorisë Profesor. Vihet re një përmirësim në vite e cilësisë së stafit lidhur me kualifikimin e tyre akademik. Gjithashtu vlen të theksojmë dhe faktin që në këtë program studimesh ka mjaft staf akademik të ardhur nga vende të tjera.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit jepet në Tabelën 3 në Aneks

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet PAE/PAK midis tyre jepen në Tabelën 4 dhe 4.1 në Aneks.

Për vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **6 personel akademik efektiv (PAE)**, nga ku 5 janë më tituj/grada, dhe **3 personel akademik me kontratë (PAK)** ku të gjithë janë me tituj/grada. Pra **66.7% PAE**.

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **7 personel akademi kefektiv (PAE)**, dhe **3 personel akademik me kontratë (PAK)**, pra **70% PAE**.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **7 personel akademi kefektiv (PAE)**, dhe **3 personel akademik me kontratë (PAK)**, pra **70% PAE**.

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **7 personel akademi kefektiv (PAE)**, dhe **4 personel akademik me kontratë (PAK)**, pra **63.6% PAE**.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **5 personel akademi kefektiv (PAE)**, dhe **5 personel akademik me kontratë (PAK)**, pra **50% PAE**.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është **5 personel akademi kefektiv (PAE)**, dhe **4 personel akademik me kontratë (PAK)**, pra **55.5% PAE**.

Nga takimet e realizuara me stafin u vu re se ngarkesa mësimore e stafit, në disa raste ishte 3 module në semester. Në gjykimin e GVJ kjo ngarkesë e stafit duhet të reduktohet. Stafi i UNYT u shpreh se ngarkesa e tyre mësimore reduktohet në vartësi të situatës së tyre në punën shkencore. U dëshmuar raste ku ngarkesa mësimore është reduktuar kur stafi akademik ka qenë në studime doktorale, për të lehtësuar punën e tij. Gjithashtu, vlen të thekësohet edhe ngarkesa e disa pedagogëve efektive është e lartë, në terminologji orësh, kursesh edhe modulesh që ata zhvillojnë. Nga të dhënat e mara në IAL u konstatuan raste ku ngarkesa e një pedagogu arrinte deri në 460 ore dhe 9 kurse për vitin 2018/2019, 415 ore dhe 12 kurse për vitin 2017/2018 dhe 435 ore dhe 12 kurse për vitin 2016/2017. Në mendimin e ekspertëve kjo ngarkesë është shumë e madhe, dhe mund të bëhet një riorganizim më i mirë i ndarjes së orëve.

Rekomandohet që të reduktohet ngarkesa në orë dhe kurse e stafit akademik efektiv.

Të dhënat sipas moshës jepen në Tabelën 4.2 në Aneks

Vlen të thekësojmë se vihet re një shpërndarje e stafit akademik sipas të gjithë grupmoshave. Ndërkohë që stafi administrativ është kryesisht në moshe të re, 25-35 vjec. Rreth 50% e stafit administrativ janë në këtë grupmoshë. (Tabela 4.2 në Aneks)

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në institucion, GVJ realizoi edhe një vizitë me zyrën e Burimeve Njerëzore. Aty u pa nga afër puna që bënte kjo zyrë për rekrutimet e reja, në bashkëpunim të ngushtë me departamentet. Kontrata e punës për stafin përcakton edhe modalitetet lidhur me vlerësimin vjetor të punës dhe përmbushjen e detyrave. Kushtet e kontratës së punës, koha për të cilën lidhet ajo dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me marrëdhëniet juridike të punës trajtohen sipas legjislacionit në fuqi. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë nuk mund të punësohet njëkohësisht si personel akademik me kohë të plotë në një institucion tjetër të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit, por mund të angazhohet me kohë të pjesshme vetëm në një institucion tjetër të arsimit të lartë, me miratimin e rektorit. (kjo në përputhje me aktet nënligjore në fuqi). Stafi akademik si edhe ai administrativ ishte i qartë lidhur me të drejtat dhe detyrimet që ka.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Secili nga Fakultetet e UNYT, ka sekretare që mbulon marrëdhëniet me studentët që nga momenti i regjistrimit fillestar deri në përfundim të të gjithë procesit të studimeve. Gjithashtu ato janë përgjegjëse edhe për mbarëvajtjen e procesit mësimor, ndjekjen e orarave të zhvillimit të mësimin, regjistrat e mësimin. *GVJ konstaton se UNYT ka nevojë për rritje të numrit të stafit ndihmës për të ndihmuar*

mbarëvajtjen dhe rakordimin në procesin mësimor. Gjithashtu rritja e stafit ndihmës do të mundësonte një mbarëvajtje më të mirë të zyrave të tjera mbështetëse, si Marrdhëniet me jashtë, Zyra e projekteve. Kjo do të lehtësonte paksa edhe situatën e rendesës së stafit akademik me detyra administrative.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|---|
| Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve. | |
| <p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> | <p>GVJ, bazuar mbi RVB, takimet me stafin akademik të programit dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion vëren se, personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre.</p> <p>Ky personel akademik angazhohet në përputhje me strategjinë e kerkimit dhe statutin e institucionit. Përvë procesit mësimdhënies ata janë të angazhuar në përfshirjen në konferenca shkencore dhe në botime (<i>Aneksi 1 RVB, Statuti, Aneksi 21. Strategjia e kerkimit, Vizita në institucion</i>)</p> |
| Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit. | |
| <p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> | <p>Bazuar në informacionin e siguruar nga RVB dhe vizitën në institucion, çdo titullar lënde, ka të drejtën dhe njëkohësisht detyrimin që të ndërtojë syllabusin e çdo lënde të planit mësimor si dhe të propozojë ndryshimet e nevojshme për përmirësim e vazhdueshëm të lëndës. GVJ konstaton se në nivel departamenti, trajtohen dhe diskutohen problematikat dhe nxitet përmirësimi i programeve dhe kurrikulës. (<i>Vizita në institucion</i>)</p> <p>Bazuar në nevojat e institucionit dhe të programit të studimit, rekrutimi i personelit dhe caktimi i ngarkesave mësimore respektive synon të bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. (<i>Aneksi 7.1, 7.3 RVB, Vizita në institucion</i>)</p> |
| Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të</p> | <p>GVJ mbështetur mbi informacionin e siguruar në takimet me drejtues të institucionit dhe me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore, konstaton se UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren. Referuar informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, (Tabela 4, në Aneks), personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimeve "Master i shkencave" në "Financë dhe kontabilitet", në vitin 2013-2014 ka qënë 5 PAE ndaj 4 PAK, në 2014-2015 ka qënë 5 PAE ndaj 5 PAK, në vitin 2015-2016 ka qënë 7 PAE ndaj 4 PAK, në vitin 2016-2017 ka qënë</p> |

raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.

7 PAE ndaj 3 PAK, në vitin 2017-2018 ka qënë 7 PAE ndaj 3 PAK dhe në vitin 2018-2019 ka është 6 PAE ndaj 3 PAK

Bazuar në shifrat e mësipërme, GVJ konstaton një përmirësim të raportit PAE/PAK në vite. Për vitet akademike 2016-2017, 2017-2018, kjo normë është 70%.

Nga takimet e realizuara me stafin u vu re se ngarkesa mësimore e stafit, në disa raste ishte e lartë. Në gjykimin e GVJ kjo ngarkesë e stafit duhet të reduktohet. Stafi i UNYT u shpreh se ngarkesa e tyre mësimore reduktohej në vartësi të situatës së tyre në punën shkencore. U dëshmuar raste se ngarkesa mësimore është reduktuar kur stafi akademik ka qënë në studime doktorale, për të lehtësuar punën e tij.

Gjithashtu, vlen të thekësohet edhe ngarkesa e lartë e disa pedagogëve efektive, në terminologji orësh, kursesh edhe modulesh që ata zhvillojnë. Nga të dhënat e mara në IAL u konstatuan raste ku ngarkesa e një pedagogu arrinte deri në 460 ore dhe 9 kurse për vitin 2018/2019, 415 ore dhe 12 kurse për vitin 2017/2018 dhe 435 ore dhe 12 kurse për vitin 2016/2017. Në mendimin e ekspertëve kjo ngarkesë është shumë e madhe, dhe mund të bëhet një riorganizim më i mirë i ndarjes së orëve.

GVJ konstaton se UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Gjatë vizitës në institucion GVJ identifikoi praktika të ndryshme të vlerësimit të personelit, si vlerësimi nga studentët, vlerësimi nga drejtuesit dhe vetëvlerësimi. Forma të tilla vlerësimi konstatohen të depozituara në dosjet personale të stafit, pranë burimeve njerëzore.

Gjatë vizitës në institucion dhe inspektimit të praktikave të rekrutimit, GVJ konstatoi se institucioni, disponon një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve në web-in, për vende vakante, etj.

Dokumentacioni lidhur me procesin e rekrutimit dhe seleksionimit (komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë, dosjeve të aplikantëve) depozitohet dhe mbahet në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve përëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p> | <p>Përgjegjësi i programit studimi ka gradë shkencore dhe titull Prof. Asoc. Dr. dhe ka përvojë akademike dhe profesionale disa vjeçare.</p> <p>Referuar informacionit të marë nga IAL të gjitha lëndët udhëhiqen nga staf akademik që mbajnë të paktën gradën “Doktor” (Tabela 4 në Aneksë).</p> <p>Të gjithë drejtuesit në strukturën organizative, Rektori, Zv/Rektori, Dekani, Përgjegjësi i Pëpartmentit dhe i programit, janë të punësuar me kohë të plotë në UNYT.</p> <p>Referuar vizitës në institucion, UNYT ka personel për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. (Aneksi 2.5; 2.6 RVB) Përcaktimi i udhëheqësve për temat e Masterit bëhet në përputhje me fushat e interesit të atafit pedagogjik. Nuk u konstatuan raste të udhëheqjeve jashtë fushave të ekspertizës. Nga dokumentet e siguruar nga vizita në institucion, udhëheqësit kanë një numër jo më të madh se 10 udhëheqje diplomash në të njëjtën periudhe kohore. UNYT mundohet ta mbajë këtë numër më të ulët për të mos cënuar cilësinë e punës dhe të mbingarkojë udhëheqësit. (Aneksi 2.5; 2.6 në RVB)</p> |
| <p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p> | <p>GVJ konstatoi se çdo student që ndjek këtë program studimi zgjed h dhe i caktohet një udhëheqës për punën e tij kërkimore dhe për temën e diplomës që duhet të përgatisë për të përfunduar studimet e këtij cikli. Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”. Studentët informohen për fushat e ekspertizës së pedagogëve përkatës për të mundësuar një përputhje sa më të mirë të temës së tyre me ekspertizën e pedagogut udhëheqës.</p> <p>Nga dokumentet e siguruar nga vizita në institucion, udhëheqësit kanë një numër jo më të madh se 10 udhëheqje diplomash në të njëjtën periudhe kohore. Normalisht IAL mundohet ta mbajë këtë numër më të ulët për të mos cënuar cilësinë e punës dhe të mbingarkojë udhëheqësit. (Aneksi 2.5; 2.6 në RVB)</p> |
| <p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën</p> | <p>Nga të dhënat që iu vendosën GVJ në dispozicion, vërehet se pedagogët e angazhuar në këtë program studimi janë të specializuar në një fushë studimore-kërkimore të njëjtë apo në përputhje me fushën studimore të këtij programi studimi.</p> |

është parashikuar të hartohet teza.

Këta pedagogë zotërojnë njohuri dhe aftësi të avancuara teorike dhe kërkimore në financë dhe kontabilitet dhe orientojnë studentit për temën e diplomës.

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;
Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.

UNYT dhe Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit ka angazhuar me kohë të plotë, personel ndihmës mësimor – shkencor, të kualifikuar, për realizimin optimal të programit të studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”.

IAL ka siguruar një mbështetje të plotë me mjetet e nevojshme, si laboratorë dhe mjedise shkollore. (Vizita në IAL)

GVJ vlerëson se UNYT siguron personelin e mjaftueshëm akademik për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e temave të diplomave në bazë të fushave të interesit që kane studentet në përputhje me fushat e stafit.

Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

GVJ, referuar RVB por edhe takimeve në institucion vlerëson se, pedagogët me grada e tituj duhet të plotësojnë ngarkesën fillimisht në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. Referuar ngarkesës së 2018-2019, nuk rezultojnë raste kur stafi akademik mbulon lëndë jashtë profilit. Gjithashtu u konstatua nga takimet me stafin se ngarkesa që ata marini nuk i kalon 3 module në semestër. IAL aplikon ulje të ngarkesave të stafit pedagogjik në rastet kur ata janë në proces të studimeve pasuniversitare si doktoratura. Referuar evidencës së ngarkesës që raportohet nga institucioni për gjithë vitet për të cilat bëhet akreditimi pas vizitës në institucion, rezulton se ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimeve Master Shkencor ne Finance dhe Kontabilitet, vlerësohen me orë mësimore sipas koeficenteve përkatës.

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

UNYT, disponon një bazë të dhënash të plotë dhe që azhurnohet vazhdimisht në lidhje me stafin akademik të përfshirë në programin “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”. Gjatë vizitës në IAL, GVJ shqyrtoi në mënyrë rastësore disa dosje të stafit dhe kontatoi se ato janë të plota në të gjithë elementët e tyre.

UNYT, disponon për çdo semestër listën e stafit akademik dhe mbështetës, që do të angazhohet në këtë program.

UNYT, ka të përcaktuara kriteret për rekrutimin e stafit, kriteret këto që publikohen në mediat e shkruara apo në faqen zyrtare e institucionit.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ, bazuar në dokumentacionin e ofruar nga institucioni, vizitat në institucion dhe informacionin shtesë të siguruar gjatë këtyre vizitave, konkludon se:

UNYT ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren. UNYT promovon personelin efektiv dhe atë me kontratë duke i mbështetur ato me pjesëmarrje të tyre në aktivitetet kombëtare e ndërkombëtare.

Për vitet akademike 2016-2017, 2017-2018, raporti PAE/PAK është 70%.

Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

GVJ konstaton një ngarkesë të lartë të stafit akademik të angazhur në këtë program studimesh. Rekomandohet që të bëhet një riorganizim i orëve dhe të ulet ngarkesa mësimore e stafit akademik, në terma të orëve dhe kurseve të mbuluara gjatë një viti akademik.

Kualifikimi akademik dhe shkencor i stafit akademik të angazhuar në këtë program studimesh është mjaft i mirë.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

UNYT I kushton vëmendje infrastrukturës dhe rolit të saj në rritjen e cilësisë të programeve mësimore. GVJ konsideron vendim të logjikshëm zhvendosjen e institucionit dhe kryerjen e veprimtarisë akademike tek “Kodra e Diellit”, një godinë 7 katëshe, me një pamje tejet piktoreske.

Infrastruktura e institucionit dëshmon jo vetëm seriozitetin dhe përgjegjshmërinë e stafit, por edhe funksionalitetin e saj në shërbim të cilësisë së programeve. UNYT paraqitet i kompletuar me salla leksioni, seminare, konferenca, laboratore si edhe me të gjitha paisjet e nevojshme teknike dhe didaktike, me një mobilim tejet të këndshëm dhe të përshtatshëm.

Edhe infrastruktura ndihmëse (furnizimi me energji elektrike, uji, ngrohja) janë siguruar në shërbim të cilësisë së programeve të studimit dhe të komoditetit të personelit akademik dhe studentëve.

Siç paraqitet në Tabelën 6, Aneks, UNYT iu përmbahet normave të hapësirës së përdorshme, me një raport prej 2.5 deri në 5 m² për student.

Biblioteka e UNYT siguron një ambient pozitiv, të përshtatshëm dhe të rehatshëm për lexuesin, infrastrukturë teknike për zhvillimin dhe përdorimin e burimeve online për kërkim shkencor, burime informacioni për studentët dhe stafin akademik.

Studentët mund të shfrytëzojnë për qëllimet kërkimore edhe baza të të dhënave dhe burime nga universitetet partnere të UNYT. Gjithashtu UNYT ju ofron studentëve qasje të specializuara, soft ëare (TURNITIN) për qëllime të identifikimit të plagjiaturës si edhe të marrjes së komenteve e opinionëve menjëherë.

Siç edhe u shpjegua më lart, UNYT përbëhet përveç dy departamenteve edhe nga një qendër kërkimore, e cila është në funksion dhe në mbështetje të drejtpërdrejtë të veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Mjediset për Programin e studimit (Tabela 6 ne aneks reflekton mjediset per fakultetin/pergjegjes per programin e studimit dhe mjediset per stafin)

- Salla për leksione

- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyre informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- Zyra për personelin akademik

GVJ konstaton se situata e infrastrukturës e paraqitur dhe e përshkruar në RVB përputhet me situatën reale, të konstatuar gjatë vizitës në institucion.

GVJ gjykon që Infrastruktura në përgjithësi, është një nga përparësitë e UNYT. Jo vetëm infrastruktura akademike, por edhe ambientet kulturore, sportive, argëtuese e zhvilluese janë të përshtatshme për të mbështetur cilësinë e punës kërkimore dhe garantuar mirëqenien dhe shëndetin e studentëve dhe stafit akademik. Institucioni e ka trajtuar me shumë vëmëndje çështjen e infrastrukturës. Në të gjitha diskutimet, studentët kanë qenë pjesë e vendimmarrjes dhe mendimi i tyre është konsideruar. Jo vetëm zbatimi i normave, siç edhe ilustron nga Tabela 6, por edhe opinionet e të intervistuarve, forcojnë bindjen e GVJ se UNYT ka investuar me seriozitet, në funksion të ndërtimit të një infrastrukture që ti shërbejë mësimdhënies cilësore.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p> | <p>Ndertesa dhe kampusi i UNYT janë të mirembajtura dhe ofrojnë kushte moderne. UNYT është i pajisur me të gjitha pajisjet e përshtatshme për të mbështetur dhe kryer studimet në përputhje me orarin dhe nevojat sociale të studentëve. Mesatarisht, hapësirat për dritaret mbulojnë afro 70% të sipërfaqes. Përpara çdo fillimi të viti akademik behet rinovimi i certifikates së sigurisë ndaj zjarrit dhe asaj higjienike. Ka sistem ngrohjeje dhe ftohjeje qendror që siguron zhvillimin normal dhe krijimin e kushteve për mesimdhënie. UNYT ka gjenerator për të prodhuar energji elektrike në rast të mungesës apo siguron furnizimin me ujë.</p> |

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

GVJ mbështetur tek të dhënat e siguruar nga RVB si edhe nga vizita në institucion konstaton se institucioni, në përpjekje për të realizuar një proces mësimor sa më cilësor, ju siguron studentëve akses tek literature e zgjedhur, bashkëkohore dhe në sasi të mjaftueshme. Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme nëpërmjet bibliotekës, e cila disponon literature cilësore dhe të pasur, kryesisht në gjuhë të huaj, në fushën e shkencave ekonomike, tekste mësimore dhe literature ndihmëse.

Biblioteka e UNYT është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka mjaftueshëm vende leximi dhe paisje teknologjike, për të garantuar punën akademike dhe kërkimin shkencor të studentëve.

Biblioteka e UNYT furnizohet vazhdimisht me botime periodike. Institucioni mbështet gjetjen e burimeve online të kërkuara nga pedagogët dhe studentët. Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare më prestigjioze (McGraë-Hill) (marëveshje 2017)

Orari i shërbimit është i njohur për studentët dhe i përshtatshëm sepse biblioteka është e hapur gjatë të gjithë ditës.

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

GVJ, gjatë vizitës në institucion vërejtë se: UNYT ka krijuar një strukturë logjistike të vlerësueshme për punën e pedagogëve dhe të studentëve në ambientet e tij. UNYT ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë si edhe salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit.

Pajisjet e mjediseve mësimore në UNYT janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen PC-te Projektorët dhe Sistemi i fonisë. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit.

UNYT ka krijuar mundësinë e pajisjes së sallave mësimore me mjete moderne për t'u përdorur nga pedagogët dhe për të perfeksionuar procesin mësimor me mjetet teknologjike audiovizive, lidhjet me internet, etj. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.

UNYT garanton mbarëvajtjen dhe mbështetjen logjistike dhe me bazë materiale në realizimin e kërkuar sasior dhe cilësor të programit. Sa i takon praktikave profesionale, UNYT ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Bibliotekë, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Praktikave, Zyrën e Aktiviteteve, Zyrën e IT-së, pranë koordinatoreve të Departamenteve. Megjithatë pjesa më e madhe e kërkesave janë akomoduar në institucionet dhe kompanitë me të cilat UNYT ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi .

Konkluzionet e vlerësimit:

Në përputhje dhe zbatim të metodologjisë së vlerësimit, GVJ konsideron se UNYT ka krijuar logjistikë funksionale dhe mjedise pune të përshtatshme si për pedagogët dhe studentët. Ai garanton dhe pasuron vazhdimisht bazën materiale për realizimin e kërkuar sasior dhe cilësor të programit. Kjo pasqyrohet në të gjitha drejtimet e infrastrukturës si dhe evidentohet qartazi nga treguesit e matshëm. UNYT siguron që ky program të realizojë misionin e vet në kushte të mira, me teknologji dhe pajisje moderne.

Në lidhje me shërbimin dhe cilësinë e ofrimit në bibliotekë, GVJ gjykon se biblioteka e UNYT është e pasur dhe disponon literaturën e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse, ka mjaftueshëm vende leximi dhe pajisje teknologjike, për të garantuar punën akademike dhe kërkimin shkencor të studentëve, si dhe furnizohet vazhdimisht me botime periodike si dhe me gjetjen e burimeve on-line të kërkuara nga pedagogët dhe studentët.

Orari i shërbimit është i njohur për studentët dhe i përshtatshëm sepse biblioteka është e hapur gjatë të gjithë ditës.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Referuar Tabelës 6, në Anekse, institucioni paraqet të ardhurat për vitet nga 2012-2017. Këto të ardhura, janë siguruar nga tarifat e shkollimit, grantet për kërkim si dhe nga aktivitetet tregëtare. Për vitin 2017, të ardhurat nga tarifat e shkollimit përbëjnë 94.4%, të ardhurat nga grantet për kërkime dhe kontratat përbëjnë 5%, dhe të ardhurat nga aktivitetet tregëtare 0.6%.

- Grantet për kërkim kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit për të arritur vlerën më të lartë të tyre në vitin 2017.
- Duke qënë një IAL jopublike, UNYT nuk ka përfituar të ardhura nga pushteti qëndror apo vendor.
- Konsulencat, shërbimet, **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë asnjë viti të marë në shqyrtim.
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit kanë siguruar pjesën më të lartë të të ardhurave gjatë të gjithë viteve.
- Sponsorizimet **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë asnjë viti të marë në shëyrtim..
- Shërbimet trainuese **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë asnjë viti të marë në shëyrtim..
- Donacionet, aktivitetet siguroese etj **nuk** kanë siguruar të ardhura gjatë asnjë viti të marë në shqyrtim.

- Aktivitetet tregtare kanë siguruar të ardhurave relativisht të ulta.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi në vitin 2017 (në përqindje):

- Grantet për kërkim 5%
- Konsulencat, shërbimet 0
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 94.4%
- Sponsorizimet 0
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 0
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj 0
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0.6%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Të dhënat për kostot e studimit për student në programin e studimeve “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”, paraqiten në Tabelën 6, në Anekse.
Vihet re një rritje graduale nga viti në vit e kostos së studimeve për student. Për vitin akademik 2016-2017 u konstatua një kosto shumë e lartë krahasuar edhe me vitet e tjera të mara në shqyrtim, prej 9,432€.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare. | |
| <p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p> | <p>Referuar RVB, UNYT ka raport auditit vjetor të brendshëm edhe të jashtëm. Auditit i jashtëm realizohet nga një kompani e pamvarur.</p> <p>Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë, përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve si dhe analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve.</p> <p>Raportet përmbajnë transparencë në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe kategorizimin në llogaritë përkatëse, shfrytëzimin dhe eficiencën e të ardhurave për funksionimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies, kërkimeve shkencore për studentët.</p> |
| Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve. | |

Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.

Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

UNYT harton raportin vjetor financiar i cili përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve.

GVJ konstaton prej informacionit të paraqitur në RVB dhe takimeve në IAL, se janë ulur të ardhurat nga tarifat e shkollimit, si dhe ka patur një rritje graduale nga viti në vit të grantit për kërkim. Duke qënë se pjesa më e madhe e të ardhurave të IAL vjen nga tarifat e shkollimit, sygjerohet nga GVJ;

- Zgjerimi i mundësive të IAL për thithjen e të ardhurave nga forma të tjera.
- Rritja e numrit të studentëve (kjo është edhe ne strategjitë e ardhshme të IAL, Takimi 1)

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konkludon se UNYT paraqet kostot e programeve të studimeve në nivel programi studimi dhe paraqet pasqyrën e të ardhurave dhe financimet gjatë viteve të fundit
UNYT realizon raporte auditi të përvitshme të brendshme dhe të jashtme.
Rekomandohet zgjerimi i burimeve të të ardhurave për IAL, pasi vihet re se pjese dominuese e tyre gjenerohen nga tarifat e studentëve. UNYT duhet të orientohet më shumë drejt thithjes së fondeve nga projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë pranë UNYT funksionon nëpërmjet një strukture të përherëshme përmes Komisionit për garantimin e standarteve të cilësisë së institucionit (KoGaSCI). Procedurat e sigurimit të cilësisë në UNYT janë zhvilluar gjatë gjithë viteve të aktivitetit të IAL. Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore e administrative. GVJ vlerëson përfshirjen e ekspertëve të jashtëm, në proceset e vlerësimit të brendshëm, sepse rrit objektivitetin në gjykimet dhe rezultatet e vlerësimit.

Komisioni është i përbërë nga 5 anëtarë në përbërje të të cilit ka përfaqësues nga cdo fakultet.

UNYT është i përfshirë në një projekt ERASMUS, si partner, QAINAL "Mbështetje strategjike për forcimin e strukturave të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet private të Arsimit të Lartë në Shqipëri". Fokusi i këtij prijekti është të mbështesë proceset e sigurimit të cilësisë dhe mekanizmat për të siguruar menaxhimin efektiv si dhe pr të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Në kuadër të këtij projekti janë bërë një sërë trajnimesh që sipas dëshmive në IAL i kanë shërbyer për përmirësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Anketimet e studentëve bëhen 2 herë në vit, në përfundim të çdo semestri. GVJ e konstatoi këtë fakt si nga RVB edhe nga takimet e zhvilluara në IAL. Ky proces monitorohet nga koordinatori dhe zyrës së sigurimit të cilësisë. Rezultatet pasi dalin ndahen fillimisht me titullarët dhe më pas shkojnë nëpër departamente.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Gjatë takimeve, GVJ-së iu vendos në dispozicion informacion mbi mënyrën e funksionimit, rregulloren e kësaj zyre, planin e veprimit, format e pyetsorëve të kryer etj. Në aktivitetin e saj, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë e zhvillon veprimtari të organizuar sipas një plani kalendarik të përvitshëm në të cilin programohen kontrollat apo proceset që i nënshtrohen kontrollit. Disa nga mjetet që përdoren për kontrollin brendshëm të cilësisë janë, Course evaluation template, Individual performance assesment, Peer evaluation form, Raporti i paanshmërisë, Transparencës, Krahasueshmërisë dhe Auditimin. (Anekse 23,24, 25, 27 në RVB)

GVJ konstaton, nga komunikimi me KSBC dhe me studentët e programit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”, se për vlerësimin e programit të studimeve, dhe të stafit të përfshirë në të KSBC, përdor metoda alternative, ku përveç pyetsorëve masivë on-line, organizohen dhe fokus grupe me studentët, për të siguruar informacion shtesë, informacion më cilësor, dhe për të shmangur asimetrinë e informacionit. Skedat e pyetësorëve përpunohen përmes programit të përdorur për vlerësimin online dhe i vendosen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar çdo pedagogu.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Përgjegjësia për monitorimin dhe menaxhimin e zhvillimit të pyetësorit, është e tutullarëve, dhe zyrës së NJSBC. Të dhënat lidhur me anëtarët e NJSBC dhe anëtarët aktual të Komisioni janë në Tabelën 7 në Anekse.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vlerësimet e mara nga pyetësorët e studentëve si dhe format e tjera të kontrollit që aplikohen në UNYT, janë pjesë a analizës vjetore të departamenteve. Rezultatet u jepen personalisht anëtarëve të stafin në rastet kur paraqesin problematike. Nga vizita e kryer nuk u raportuan raste që kanë cuar në marjen e masave disiplinore nga ana e UNYT. Studentët gjatë takimit me ta u shprehën se në ato raste kur janë paraqitur problematika të vogla lidhur me mënyrën e shpjegimit, janë superuar nëpërmjet dialogut direkt në lektorin e lëndës.

Të dhëna lidhur me numrin e studentëve të anketuar në vite për këtë [program studimi jepen në Tabelën 7.1 në Anekse.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|--|
| Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> | <p>Universiteti i Neë York, Tiranë, e ka të institucionalizuar procesin e vlerësimit, nëpërmjet rregulloreve përkatëse por edhe kërkesave që shoqërojnë programin në syllabuset e çdo lënde/modul. Ky informacion është pjesë e vlerësimit institucional, në raportin e të cilit është pasqyruar mënyra e vlerësimit dhe metodologjia e tij. Rezultatet e vlerësimit bëhen publike në raportin vjetor. Metodatat e përdorura janë të natyrave të</p> |

Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.

Të tërthorta:

- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;
- Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista;
- Etj.

Të drejtpërdrejta:

- Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj.);
- Dëgjime në auditor;
- Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;
- Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;
- Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);
- Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;
- Etj.

ndryshme, sondazhe, pyetësor, intervista, kontrolle të procesit mësimor etj. (Aneksë 23, 24, 25, 26 në RVB)

Disa nga metodat e vlerësimit janë: Students' evaluation form, Peer evaluation form, Formulari i performancës së vlerësimit individual, raporti i vlerësimit vjetor të Departamentit.

Të gjitha këto GVJ i konstatoi direkt në institucion nëpërmjet kontrolleve të dokumentacioneve por edhe pyetjeve të studentëve e stafit akademik, vec takimit me NjsBC.

Universiteti i Neë York, Tiranë, disponon edhe një manual të Sigurimit të Cilësisë, që shërben si bazë për ecurinë e kësaj zyre. (Aneksi 35, RVB)

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;

Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.

Referuar RVB, UNYT përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Këto raporte janë pjesë e diskutimit dhe prezantimit në nivel rektorati, sikurse dhe në nivel departamenti.

Gjithashtu UNYT publikon në faqen e ëebit si dhe në vende të posacme në IAL të gjithë indormacionin e nevojshëm që lidhet me ecurinë dhe mbarëajtjen e programit të studimit, lëndët, oraret, etj.

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të

Referuar RVB, takimeve me NjsBC dhe drejtues rezultojn se UNYT analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti, ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin dhe opinionin e studentëve.


Bazuar në feedback-un e marrë nga studentët,

| | |
|---|--|
| <p>ciklit të dytë.</p> | <p>nëpërmjet pyetësorëve dhe fokus grupeve por dhe aktorëve të tjerë, UNYT programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p>Gjatë takimeve me stafin, ata u shprehen se kanë patur raste kur kanë ndryshuar gjare të vogla brënda sylabuseve të moduleve si pasojë e sygjërimeve të ardhura nga studentët. Për këto ndryshime ata kanë patur liri të plotë dhe mbështetjen e titullarëve të IAL.</p> |
| <p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p> | <p>Institucioni UNYT, ka kryer akreditimin parë në vitin 2006. Në vitin 2017 UNYT ka marrë akreditimin institucional me vendim Nr.102 të Bordit të Akreditimit date 10.11.2017, për 3 vite akademike.</p> <p>Institucioni ka NjSCB, e cila periodikisht bën vlerësimin e cilësisë së brendshme në institucion duke e shoqëruar për cdo vit akademik me një raport të detajuar për aktivitetin e institucionit në Senatin Akademik.</p> <p>Ne konstatuam se problemet që ngre njesia e sigurimit të brendshëm të cilësisë, shërbejnë si udhëzues për përmirësimin e veprimtarisë akademike bile edhe për aplikimin e masave administrative për rastet e shkeljeve që çenojnë etikën e institucionit dhe të procesit mësimor.</p> <p>Politikat e institucionit për ndërgjegjësimin e stafit dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë janë të materializuara në strategjinë e zhvillimit të UNYT e cila është e publikuar dhe zotërohet nga stafi akademik.</p> |
| <p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Sa më sipër, GVJ konstaton se standartet për sigurimin e cilësisë së brendshme të procesit të arsimimit në këtë IAL përmbushen plotësisht. Siguria në procesin e menaxhimit të cilësisë së brendshme shprehet në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet NjSBC dhe të gjithë strukturave akademike, duke qënë konkret në atë që bëhet dhe planifikimin e vazhdueshme për të siguruar reflektimin e masave që kjo njësi nxjerr në veprimtarinë akademike. Institucioni ka zhvilluar procesin e kontrollit të brendshëm të cilësisë peridikisht duke mbajtur nivelin e procesit mësimor në kushtet optimale të kërkesave e standardeve përkatëse. Sikundër edhe UNYT shprehet mbetet sfidë për të ardhmen përshtatja dhe funksionimi sipas Kodit të ri të Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë, miratuar në 11/09/2018.</p> | |

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi "Master i shkencave" në "Financë dhe kontabilitet" u licencua me vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 939, datë 03.09.2009 si "Diplome e Nivelit të Dytë", sipas terminologjise së Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Në zbatim të Nenit 99/3 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, ky program studimi është përshtatur në programin "Master Shkencor" që realizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale 2-vjet, konfirmuar me shkresë nr. 6858/2 prot., datë 06.05.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 286, datë 25.07.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me Vendimin Nr. 490, datë 03.06.2013 të Këshillit të Akreditimit. Ky program ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, përkatesisht nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës brenda këtij fakulteti në Universitetin e Neë York-ut në Tiranë (UNYT).

Mbështetur në RVB, Ekspertët e vlerësimit shprehën se: Misioni i UNYT është përgatitja e udhëheqësve të ardhshëm nëpërmjet mësimdhënies, të të nxëniet dhe hulumtimit duke i kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit personal dhe influencës në komunitet, duke siguruar njohuritë, aftësitë, moralin dhe besimin e nevojshëm për të patur sukses në një mjedis heterogjen, ndërkombëtar.

Programi "Master i shkencave" në "Financë dhe kontabilitet" ofron dhe përfshin kurse që janë të rëndësishme për botën financiare. Programi është ndertuar me filozofinë e dhenies së mundësive të punësimit edhe në vendet e BE, përse kohe që filozofia dhe strategjia kryesore e UNYT është ajo e ndërkombëtarizimit. UNYT e ka ndertuar këtë program studimi me qëllim që t'i shërbejë vendit në kuadrin e integritetit të tij në BE por edhe për institucionet shtetërore po organizatat ndërkombëtare brenda vendit.

Përdoren një larmi metodash vlerësimi dhe testimi formative dhe akumulative, të cilat informojnë procesin e mësimdhënies. Të tilla janë diskutime në klasë, provime të shkruara (brenda ose jashtë klasës me libra të hapura apo jo), ese kërkimore, bibliografi të anotuara, dizajnime kërkimi dhe prezantime gojore, individuale apo në grupe. Vlerësimi lidhet me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit dhe informon procesin mësimor.

Orientimi i punësimit është dhe drejtohet drejt institucioneve bankare në vend si Raiffeisen, Tirana Bank, Alfa Bank, NBG, Agna apo Deloitte. Ky program studimi është i ideuar edhe për atë kategori studentesh që kanë një formë tjetër dhe të ndryshëm bachelor nga ai i financës, si p.sh., administrim biznesi, etj.

Plani mësimor funksionon si një kontratë pune ndërmjet studentit dhe pedagogut. Ai përfshin përmbajtjen e lëndës, përcaktimin e qartë të kriterëve të vlerësimit dhe detyrimet e studentit. Elementët kryesorë të mësimimit janë: leksionet, detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat profesionale, punë laboratorike, esetë, provimet, provimet e formimit, temat e diplomës etj.

Çdo lende ka 4 kredite amerikane (ACTS)/8ECTS. Lendet janë kombinim i leksioneve me seminarët, të pandara, 60 ore në total për çdo lende zhvillohet në auditor dhe 140 ore pune e pavarur. Nota minimale e kalimit është (C-) ose 70%. Studentet duhet të mbajnë një GPA kumulative 2.33 për t'u diplomuar. Nëse merret një note më e ulët se sa niveli i mesiperm, studentit i duhet të perserite të gjithë kursin. Për kategorinë e lendeve me zgjedhje duhet të kenë nivelin D (60-69%) për dy nga katër lendet me zgjedhje, pa pasur nevojë të perserisin kursin.

Stafi i angazhuar për mësimdhënie në këtë program është i kualifikuar dhe kryesisht me eksperiencë ndërkombëtare (Aneksi 2.2: CVs). Gjithashtu profesorë që vijnë nga industria dhe bota e biznesit janë angazhuar në mënyrë që t'ju ofrojnë studentëve ndërthurje të njohurive akademike me ato praktike. Të dhëna të detajuara mbi numrin e stafit të angazhuar në program dhe gradat shkencore janë pasqyruar në tabelat në aneks (pika 2 dhe 3 e këtij raporti). Literatura dhe materialet e tjera mbështetëse zgjidhen duke ju referuar kohës kur janë botuar, kredibilitetit të autorit dhe të përkthyesit si dhe nivelit të shtëpisë botuese përkatëse. Tekstet e përzgjedhura miratohen nga shefi i departamentit para çdo fillimi të vitit akademik. Gjithashtu koordinatori i programit bën projeksionet për literaturën e nevojshme dhe porosit në bibliotekën e shkollës (Aneksi 24.1: Plani i Librave të Bibliotekës BA).

Bazuar edhe në opinionet e drejtuesve të njësive bazë, literatura e plote e perditesuar dhe me mareveshjen e e 2017 te Mac Grow hill perben nder pikat e forta te programit. Nga analiza e të dhënave të Dosjes së vetëvlerësimit si dhe nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i paraqitur rezulton se ka një vijim normal dhe të strukturuar të organizimit të programit dhe mbarëvajtjes për ta monitoruar dhe manaxhuar në mënyrën e duhur. Nuk ka ndryshime që mund të çënojnë përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” është ndertuar ne menyre te tille qe t’i pajise studentet me njohuri te avancuar ne tematika te profilizuara te finances dhe kontabilitetit. Kjo mundeson studentet te perfshihen ne punesime ne sektorin e finances dhe te kontabilitetit. Programi Master ne Finance dhe Kontabilitet synon te thelloje njohurite dhe te jape nje perqasje te plote teorike duke kombinuar keto njohuri me me praktika te orientuara nga kerkimi shkencor, me qellim ndihmen dhe mbeshtetjen tek studentet per te vijuar studimet e tyre ne programet doktorale. Programi Master ne Finance dhe Kontabilitet reflekton dhe zbaton misionin dhe qellimin e institucionit.

Objektivat kryesore te ketij programi studimi lidhen dhe referohen kryesisht me:

- Te mundesoje ofrimin e njohurive bazike themelore per studentet qe vijne nsi nga financa dhe kontabiliteti ashtu edhe nga dege te tjera;
- Tju mundesoje studenteve njohjen dhe zbatimin e mjeteve te nevojshme, si dhe gjeresine dhe thellesine e disiplines per te vijuar ne nivelet e tjera te studimit ne finance dhe kontabilitet;
- T’i njohe dhe aftesoje studentet me mjetet, konceptet dhe metodologjine e duhur per pune kerkimore te pavarur dhe t’i drejtoje studentet ne etapa te ndryshme te procesit;
- Te kuptuarit e plote te detajeve teknike dhe te kornizes konceptuale te brendashkruar te disiplinave studimore te finances, kontabilitetit financiar dhe atij administrativ;
- Te vleresoje menyre kritike dhe bashkekohore kerkimin shkencor ne fushat e mesiperme;
- Te shfaqe nje kuptim themelor te metodave sasiore dhe cilesore te pershtatshme per te studiuar dhe zbatuar ne kete fushe;
- Te vleresoje dhe njohe strukturen aktuale te industrise se finances dhe kontabilitetit si dhe rendesine e programit te tyre te studimit ne te ardhmen e karrieres se tyre;
- Te shqyrtoje ne menyre kritike fushat e specialitetit permes mundesise se perzgjedhjes;
- Tiu mundesoje studenteve trajnime praktike dhe konkrete te orinetuara nga certifikatat profesionale qe do te jene te vlefshme per karrieren e tyre ne kete industri.

- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (tabela 10 ne aneksin e tabelave te masterit)

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 60 ___ orë në auditor dhe 140 ___ orë punë e pavarur e studentit

- Seminaret _20_ orë në auditor dhe _180_ orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar ___ orë në auditor dhe _1000_ orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Tabela 8 dhe 8.1 ne aneks)

Nuk ka patur ndryshime aktuale ne kurrikul per kete program. Perditsshmeria e kurrikules eshte e bazuar ne opsionet qe perzgjedhin studentet ne lendet me zgjedhje. Kjo do te thote se ne vite te ndryshme akademike studentet kane perzgjedhur lende te ndryshme qe ne fakt u jane pershtatur me mire kerkesave te tyre dhe perceptimeve te tyre per profesionalitetin e programit, perceptimin per tregun e punes, perspektiven apo peraftrimin me kritere te tjera. Ndryshime lidhen vetem me perzgjedhjen mbi bazen e kritereve te mesiperme qe bejne vete studentet.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 8.2 ne Aneks)

Nga dokumentacioni vihet re se stafi akademik reflekton njohuri te perftuara ne universitete prestigjioze ne bote dhe Europe, kohe relativisht te gjate ne mesimdhenie, perqendrim ne pergjithesi ne aftesite kerkuese, te gjitha keto reflektojne nje prirje normale drejt nje mesimdhenieje cilesore. Ne pergjithesi fushat e ekspertizes se stafit akademik perafrojne lendet qe ato mbulojne, dhe kjo i ben te rrisin kompetencat me kalimin e kohes, si dhe rrisin nivelin e mesimdhenies. Eksperte shqiptare te rendesishem ne fushen e ekonomise dhe bankave prezent me ekspertizen e tyre duke rritur aftesite mesimdhenese dhe mbeshtetur rritjen e kapaciteteve te nxenies tek studentet, sugjerohet te mbahet fort ky ritim ne ee ardhmen per te garantuar cilesine e mesimdhenies dhe rritur aftesite mesimnxenese.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Edhe nga analiza në terren (si nga takimi me stafin) ashtu edhe nga dokumentacioni rezulton se institucioni i kushton vëmendje të veçantë si formës ashtu edhe përmbajtjes së syllabusave. Nga takimi me stafin akademik rezulton se kanë liri akademike jo vetëm në përditësimin e literaturës, por edhe në

rregullimin e syllabuseve brenda formës së strukturuar të kërkuar. Syllabuset e lëndëve të ofruara në këte program studimi master janë të hartuara në anglisht. Shefi i departamentit dhe koordinatori e programit miratojnë versionin përfundimtar të çdo lënde para fillimit të vitit akademik. Të gjitha syllabuset japin informacion të detajuar mbi mënyrën e mësimdhënies, elementët e vlerësimit të studentëve, literaturën bazë dhe atë të sugjeruar, etj, duke ofruar informacion të detajuar për studentët dhe duke plotësuar kriteret e mësipërme. Nga takimi me drejtuesin e fakultetit rezultoi se institucioni e ka si praktikë kryerjen dhe përditësimin e kurrikulave.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
- Aneks 5. Strategic plan of UNYT 2018 2022
- Annex 2.2. Syllabi for each course
- Annex master thesis guidelines, etc.

Programi studimit master finalizohet me një diplomë e cila konsiderohet nga studentet dhe si shans/mundësi. Zhvillimi i gjuhës në anglisht, literatura e pasur, kurrikulat bashkëkohore konsiderohen në mënyrë të shprehur si nder treguesit me kryesore, të shoqëruara me argumentimin e një shkolle të ndërtuar me programe të unifikuara, me kulturën komunikimi amerikane që bëjnë të ndjekësh të njëjtat stile e metodologji, përben një atraktivitet dhe mundësi të shumta.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|--|--|
| Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p> | <p>UNYT në këte program studimi ofron programe studimi të akredituara, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite sipas sistemit amerikan të krediteve të ekuivalentuar me sistemin europian.</p> <p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë (të përmendura më lart) të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe karakterizojnë profilin e programit.</p> <p>Të gjithë programet e studimit konceptohen dhe hartohen në bazë të misionit të UNYT.</p> <p>Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë vitit akademik nga një student me kohë të plotë në programin e studimit është 60 kredite.</p> |
| Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. | |
| <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të</p> | <p>Konsultuar me dokumentat e vena në dispozicion por edhe nga takimet me stafet akademike dhe aktoret e tjere të interesit rezultojnë se ky program studimi zynon zgjerimin e njohurive të fituara në nivelin bachelor, si ato shkencore dhe ato praktike, përmes një rrugetimi i cili natyrisht mund të çojë në nivelin e tretë të studimeve, atë të doktoratës.</p> |

| | |
|--|---|
| <p>ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p> | <p>N/A</p> <p>N/A</p> <p>Ne lidhje me kriterin 6, gjykohet se niveli i njohurive të perftuara përmes procesit të mesimdhënis dhe jo vetëm në këtë program studimi të “Master i shkencave” krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës. Gjykimi për plotësimin e këtij standarti bazohet jo vetëm në cilësinë dhe aftësimin për kërkimin shkencor por edhe për plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin e metejshme në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>N/A</p> |
| <p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p> | <p>Programi ka objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm sipas profilit përkatës, atë të financës dhe kontabilitetit. Kete e realizon përmes metodologjise se vlerësimit të vazhduar të studenteve përmes testeve, vlerësimeve me pike, provimeve dhe testeve të ndërmjetme, për të kontrolluar dhe vlerësuar në mënyrë periodike studentet dhe njohuritë e tyre.</p> |
| <p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesore, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p> | <p>GVJ nga takimet në terren dhe konsultimet me dokumentacionin rezulton se ndërkombëtarizimi si filozofi kryesore e UNYT ka përcuar në të gjitha programet prirjen për të zhvilluar programet dhe planet përkatëse mesimore në përputhje me standartet ndërkombëtare si ato amerikane ashtu edhe europiane, e reflektuar në (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesore, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.</p> |
| <p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të</p> | <p>Programi i studimeve të ciklit të dytë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor; • hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim; • Personeli akademik angazhohet në punën |

| | |
|--|--|
| <p>Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim; Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve; Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p> | <p>kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve, dhe puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p> |
| <p>Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës; Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p> | <p>N. A.</p> |
| <p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar; Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</p> | <p>GVJ gjykon se nuk ka nje studim tregu per kete program studimi pervecse takimeve me drejtues te institucioneve kombetare dhe nderkombetare ne vend. Ka nje perpjekje per te zhvilluar nje studim tregu te quajtur Market Research Pillars 2018 te kryer nga nje grup studentesh, i cili eshte mjaft cilesore por mbetet nje analize konkurrueshmerie. Gjykohet te vijohet mbi kete studim me tej, per te relizuar vertet nje studim te tregut, te nevojave te bisneseve vendase qe kane mungesa dhe nevoja per programe te tilla, dhe qe me pas te ofrohen nga IAL si UNYT. Vijueshmeria dhe suksesi i ketij programi lidhen patjeter dhe me nevojen e ndermarrjes se nje studimi tregu, i cili nuk mbetet thjesht me diskutime midis CEO-ve apo drejtuesve te organizatave kombetare, per te kuptuar vertet nese ka nevoje tregu shqiptar per diploma dhe programe te tilla, por edhe per te mireperdorur fuqite dhe burimet qe ka UNYT ne ato drejtime qe i sherbejne me se mire ekonomise shqiptare ne radhe te pare, per te optimizuar se pari misionin e saj si IAL: per t'i sherbyer vendit.</p> |
| <p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare; Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p> | <p>GVJ gjykon se UNYT ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare dhe se programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p> |
| <p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p> | <p>Programi i studimeve “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tij është 2 vite akademike.</p> |
| <p>Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p> | <p>N. A.</p> |

| | |
|---|--|
| <p>Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p> | <p>N. A.</p> |
| <p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p> | <p>UNYT ofron te gjithë strukturen e nevojshme per te informuar studentet mbi programet, planet mesimore, syllabuset, lendet me zgjedhje, dhe cdo lloj informacioni tjeter. Kete e ben ne shume menyra si ne formatet online, permes komunikimeve elektronike, etj.</p> |
| <p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p> | <p>GVJ gjykon se jane te shumta dhe te diversifikuara per qellime te ndryshme takimet e studenteve me drejtuesit e institucionit si dhe me ato te programit apo kordinatorret perkates. Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar, dhe për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p> |
| <p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>GVJ, mbështetur në rezultatet e diskutimeve gjatë vizitës në institucion dhe dokumentacioni i paraqitur, konkludon se ka një vijim normal dhe të strukturuar të organizimit të programit dhe mbarëvajtjes për ta monitoruar dhe manaxhuar në mënyrën e duhur.</p> <p>Permbajtja e programit, hartimi i tezës, shpërndarja e krediteve, informacionet dhe menyrat e shpërndarjes se tij tek studentet reflektojnë nivelin nderkombetar te te operuarit te UNYT te zbatuar tashme pervecse edhe ne dokumenta strategjike.</p> <p>Ne lidhje me tregun e punes, GVJ gjykon se vijueshmeria dhe suksesi i ketij programi lidhen patjeter dhe me nevojën e ndermarrjes se nje studimi tregu, i cili nuk mbetet thjesht me diskutime midis CEO-ve apo drejtuesve te organizatave kombetare, per te kuptuar vertet nese ka nevojë tregu shqiptar per diploma dhe programe te tilla, por edhe per te mireperdorur fuqite dhe burimet qe ka UNYT ne ato drejtime qe i sherbejne me se mire ekonomise shqiptare ne rradhe te pare, per te optimizuar se pari misionin e saj si IAL: per t'i sherbyer vendit. Pra, per kete program studimi, ne te ardhmen UNYT duhet te ndermarre nje studim tregu qe te siguroje vertet nevojën e tregut shqiptar per pasjen e ketij programi studimi.</p> | |

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Mesimdhënia dhe përvetësimi i dijeve dhe aftësive nga studentet organizohen dhe zhvillohen në një larmi metodash dhe formash tradicionale me ato moderne, drejt kombinimit të leksioneve, workshopeve, metodave tradicionale me metodat inovative sikurse janë platformat online të MxGraW Hill, simulime, projekte, debate dhe diskutime, etj. Këto metodologji mesimdhënieje UNYT e ka ndërtuar e bazuar mbi bindjen se kombinimi i metodave të ndryshme con në përvetësimin aktiv të dijeve, njohurive edhe aftësive.

Në filozofinë e vet të reflektuar edhe në dokumentat strategjike, UNYT ka demonstruar se kombinimi i metodave të ndryshme con në të nxenurit aktiv dhe transformues. Po kështu diversifikimi i mnyrave të

vleresimit te studenteve dhe testimeve perkatese permireson dhe zhvillon kuadrin mesimdhemens dhe mesimnxenes.

Nga takimet ne terren me studentet u konkludua se UNYT perdor medota interaktive per te permiresuar mesimdhemien dhe rritur mesimnxenien. Jo vetem permes theksit ne dokumentat strategjike, por edhe e shprehur nga studentet dhe e rezultuar nga GVJ, konvergjojne se mesimdhemia e shoqeruar me te gjithë infrastrukturen e vet mbeshtetese perben nder pikat e forta te UNYT.

Permes formave te ndryshme UNYT thekson edhe permes dokumentave strategjike dhe ve theksin tek mesimdhemia. Per kete UNYT investon ne zhvillimin e burimeve akademike jo vetem per qellim te permiresimit te standarteve te mesidhenies dhe te pervetesimit te dijeve nga ana e studenteve, por edhe me qellimin e mbajtjes gjalle te debatit shkencor dhe pervetesimit me zhvillimet e fundit te praktikës se biznesit dhe shkences ne disiplina te caktuara. Persa i perket organizimit te mesimdhemien dhe formave perkatese te realizimit te saj, kombinohen permes organizimit ne forme blloqesh te oreve (sipas llojit te lendes), sesioneve paralele te kombinuara me forma aktive, kreative, dhe interaktive te te nxenurit. Perfshirja dhe kombinimi i leksioneve me seminarët, detyrat e klases, laboratorët, pune ne grup apo individuale, ushtrimeve te strukturuara me diskutimet e strukturuara apo jo, etj, perbejne nder format bazike te mesimdhemien. Kjo mundesohet edhe nga ngarkesa relativisht jo e larte e lendeve per semester qe krijon komoditet per shperndarje te oreve pergjate javes.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet (Tabela 9 ne aneks):

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

GVJ gjykon që UNYT përdor larmishmëri formash të mësimdhënies, me qëllim që të garantojë cilësinë më të mirë të mundshme si edhe efektivitetin e mësimdhënies. Leksionet dhe seminarët janë praktikë e zakonshme. Gjatë leksioneve dhe seminareve, përqimi i mesazheve ilustronet nëpërmjet ushtrimeve dhe atje ku aplikohet, përdorimi i laboratoreve.

Format e kontrollit të njohurive dhe sistemi i vlerësimit (Tabela 10 dhe 10.1 ne Aneks). Format e kontrollit të njohurive ndryshojne nga lenda ne lende, por ato mbeten brenda kuadrin te pergjithshem te mesimdhemien.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 12 ne Aneks)

Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies ka një përpjekje për të kryer vlerësime online nga studentët për pedagogët, por është ende për t'u vlerësuar në të ardhmen. Ka përpjekje për të vendosur në qendër studentin dhe për t'a përfshirë sa më shumë. Një formë është këshillimi akademik, nëpërmjet të cilit studentët përfshihen/aktivizohen në komponentët e aktivitetit të njësisë, ose përfshirja në forma të këshillimit të specializuar për mënyrën e kryerjes së obligimeve studentore. Përfshirja tek aktivitetet e qendrave mbështetëse si qendra e shkrimit akademik, janë gjithashtu forma të nxitjes së aktivizimit. Nderkohe qe duhet te gjenden forma per te perfshire dhe nxitur aktivizimin dhe pranine e studenteve prane qendres se karrieres me pike duke e institucionalizuar ne nje fare menyre, psh duke perfshire ne syllabusin e lendes intership apo ndonje lende tjeter pjesemarrjen dhe nr e caktuar te hereve/takimeve qe cdo student duhet te beje me dhe ne qendren e karrieres. Gjithsesi, studentët mbështesin idenë se kanë nevojë për më shumë internshipe, apo aktivitete që

nxisin sipërmarrjen si “inkubatorët e biznesit” dhe “start up-et”, apo duan të jenë më të përfshirë në diskutimet dhe mbledhjet periodike të njësisë bazë. Por këto ndryshime nuk ndikojnë në përmbushjen e standardeve që lidhen me këta tregues.

Ka nje politike e promovimit te stafit e cila synon te mbeshtese stafet financiarisht ne botimet dhe zhvillimet e tyre promovuese. Pas akreditimit institucional UNYT ka institucionalizuar permes nje strategjie apo dokumenti promovues. Kesaj politike i eshte atacuuar nje buxhet modest per keto nevoja, buxheti i cili shikohet cdo vit dhe eshte ne rritje. Politike mbeshtetese ndaj stafit te ri. Behen development ëorkshops sidomos per stafet e reja (deri ne 2 lende ne semester) per te mbeshtetur stafet e reja, ato qe jane kerkime doktorale apo duke bere botime shkencore. Ka nje qasje mbeshtetese dhe pozitive te drejtimit ndaj stafit te ri me qellim qe te ulen kostot e ndjekjes se studimeve doktorale, per te patur sa me te qarta objektivat e tyre, lehtesojne mesimdhenien, etj.

Sugjerohet shtim i stafit te brendshem me eksperience edhe kombetare. Fokusimi ne perzgjedhjen e stafit me shkollim dhe eksperience nderkombetare eshte ne perputhje me filozofine e pergjithshme te UNYT, por kordinimi i saj me me shume eksperteve akademike kombetare optimizon me mire objektivat e arritura. Mesimdhenia e shoqeruar me te gjithë infrastrukturen e vet mbeshtetese perben nder pikat e forta te UNYT, kjo tregohet jo vetem permes theksit ne dokumentat strategjike, por edhe e shprehur nga studentet dhe e rezultuar nga GVJ. Ne planin strategjik 2018 2022 vendosen disa prioritete midis te cilave jane studentet dhe mesimdhenia, duke synuar te perafroje me metoda sa me inovative ne mesimdhenie dhe mesimarrje. Megjithate sugjerohet qe me qellim qe te mos cenohet cilesia e mesimdhenies te rishikohet numri i moduleve qe mban/jep mesatarisht nje staf akademik ne nje semester, si dhe te rritet perfshirja e studenteve ne te gjitha elementet e funksionimit te njesise baze, qe nga mbledhjet e thjeshta, pergatitja e raporteve te vleresimit e brendshem, tek vjeljet e opinionit dhe aspekte te ndryshme te karakterit informativ deri tek ato vendimarrrese.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” u licencua me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 939, datë 03.09.2009 si program studimi i ciklit të dytë. Në zbatim të Nenit 99/3 të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007, ky program studimi është përshtatur në programin “Master Shkencor” që realizohet me 120 ECTS dhe kohëzgjatje normale 2-vjet, konfirmuar me shkresë nr. 6858/2 prot., datë 06.05.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës. Programi është akredituar për herë të parë me Urdhër Nr. 286, datë 25.07.2013 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, në përputhje me Vendimin Nr. 490, datë 03.06.2013 të Këshillit të Akreditimit. Ky program ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Biznesit, përkatesisht nga Departamenti i Ekonomiksit dhe Financës brenda këtij fakulteti në Universitetin e New York-ut në Tiranë (UNYT).

UNYT u njeh të drejtën për të aplikuar në këtë program studimi shtetasve shqiptare të pajisur me një diplomë Bachelor në Financë Kontabilitet ose profile të përafërta, të lëshuar nga një IAL e akredituar. Duke qenë se ky program studimesh në nivelin master ofrohet në gjuhën angleze, studentët që pranohen në këtë program duhet të dëshmojnë paraprakisht nivel të mjaftueshëm të saj, mbrojtur në një nga testet e njohura TOEFL/TOIC. Në rastet kur aplikantët nuk e disponojnë këtë diplomë, UNYT i asiston me anë të qendrës së gjuheve të anglishtes pranë UNYT.

Si dokumentacion bazë studentëve u kërkohet formulari i aplikimit, diploma dhe lista e notave të shkollës së mesme dhe Bachelor, CV, foto dhe fotokopje e kartës së identitetit.

Zyra e pranimit të studentëve meret me zbatimin e procedurave për pranimit e reja. (Aneks 18.2, 18.1 RVB) Numri i studentëve luhet nga 5 në 14 studentë të regjistruar për herë të parë në 6 vitet e fundit akademike. Universiteti i ndjek nga afër studentët e tij edhe pas përfundimit të studimeve nëpërmjet zyrës së karrierës dhe alumni. (Aneks 20.1 RVB) Kjo zyrë disponon një databazë të plotë të të gjithë studentëve që kanë përfunduar studimet. Vlen të thekësohet një normë punësimi mjaft e lartë për studentët që kanë përfunduar këtë program studimesh.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve

Dokumentacioni që depozitohet nga studentët për aplikim në programin e studimeve "Master i shkencave" në "Financë dhe kontabilitet", janë:

- Formulari i aplikimit,
- Diploma dhe lista e notave të shkollës së mesme
- Diploma dhe lista e notave të studimeve Bachelor,
- CV,
- Foto dhe fotokopje e kartës së identitetit
- Dëshmi e gjuhës angleze, niveli B1/B2 (TOEFL, IELTS, APTIS)

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje e studentëve në UNYT është mesatare, në shumicën e viteve (2013-2019) mbi 8. Nga të dhënat e takimit në IAL u konstatua se në përgjithësi cilësia e studentëve vjen duke u rritur përgjatë viteve të studimeve universitare. (Tabelën 11 në Aneksë) Duke iu referuar të dhënave të mara nga UNYT lidhur me notën hyrëse të studentëve, ajo varion nga 7.74-8.13 për vitet 2013-2019. GVJ vlerëson se kjo notë mesatare hyrëse është e një niveli mesatar të pranueshëm për këtë nivel studimesh. Megjithatë nuk vihet re një rritje e notës mesatare në vite, madje mund të themi se për vitin e fundit akademik 2018-2019 nota mesatare hyrëse e studentëve është më e ulëta në vite, 7.74

Nga takimet e zhvilluara me stafin dhe studentët, u konstatua se vlerësimi i studentëve bazohet në performancën e tyre përgjatë gjithë vitit akademik. Në këtë IAL aplikohet një vlerësim i tillë që studentët duhet të arrijnë 70% të pikëve për tu klasifikuar si kalues në modulën përkatës. Gjatë takimit me studentët, GVJ shprehu shqetësimin se kjo mënyrë vlerësimi mund të ishte paksa rënduese për studentët, megjithatë ata u shprehën se kjo mënyrë vlerësimi i nxit për të rritur performancën e tyre.

Të dhënat lidhur me cilësinë e studentëve jepen në Tabelën 11 në Aneksë

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

Të dhënat lidhur me cilësinë e studentëve jepen në Tabelën 11 në Aneksë

- Të dhëna për punësimin e studentëve (në përputhje me diplomën dhe jo në përputhje me diplomën),
Numri total të diplomuarve,

Punësimi i studentëve është në fokus të Universitetit të New York-ut në Tianë. Bazuar në të dhënat e ofruara nga IAL vihet re se përqindja e të punësuarve krahasuar me numrin e studentëve të regjistruar është shumë e mirë.

Punësimi është në masën 100% sipas të dhënave të mara në IAL. Duke analizuar të dhënat GVJ konstaton se për çdo vit të marë në shqyrtim, të gjithë të punësuarit janë në përputhje me diplomën, gjë që dëshmon më së miri suksesin e këtij programi studimesh. Megjithatë gjatë takimeve në IAL u konstatua se një pjesë e studentëve janë në punë që në momentin kur fillojnë studimet e tyre Master.

Të dhënat lidhur me punësimin e studentëve (në përputhje me diplomën dhe jo në përputhje me diplomën),

Numri total të diplomuarve jepen në Tabelën 11.1 në Aneksë.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|-----------------------------|
| Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë. | |

| | |
|---|---|
| <p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p> | <p>Të gjithë studentët që janë të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve, kanë përfunduar paraprakisht një cikël studimesh të nivelit të parë Bachelor në Financë Kontabilitet ose një profil të ngjashëm me së paku 180 ECTS. (Aneks 18.1, 18.2, 38, RVB, Takimi me studentët)</p> <p>Pranimi dhe regjistrimi i kandidatëve në programin e ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet” kryhet sipas udhëzimeve të MAS, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.</p> <p>Nga IAL përdoret si kriter i veçantë për përzgjedhjen e kandidatëve zotërimi i gjuhës angleze në nivelin B1/B2.</p> |
| <p>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p> | <p>Pranë Institucionit është ngritur Zyra e Karrierës dhe Zyra Alimni. Zyra e Karrierës është mjaft aktive, dhe ofron shërbimin e këshillimit për karrierën e ardhëshme të studentëve.</p> <p>Gjithashtu strukturat drejtuese, si Përgjegjësat e Departamenteve, Dekanati dhe Alumni, ofrojnë mbështetje për punësim të studentëve si gjatë studimeve dhe pas mbarimit. Zhvillimi i panairit të punës është një mundësi shumë e mirë që ofron IAL në këtë drejtim. Gjatë takimeve me studentët u konstatuan raste të punësimit të studentëve si pasojë e kontakteve gjatë këtij panairi.</p> <p>Studentët janë të mirëinformuar lidhur me procesin e akreditimit institucional dhe të programeve që ofron UNYT.</p> |
| <p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë</p> | <p>Institucioni disponon të dhëna statistikore për numrin e regjistruarve dhe të diplomuarve. Keto të dhëna disponohen nga sekretaria mesimore. (Tabela 11 në Aneks) Statistikat perkatëse dërgohen periodikisht, në zyren e statistikave në MAS.</p> <p>Institucioni ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> |

| | |
|---|--|
| <p>akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p> | <p>Sekretaria mësimore disponon jo vetëm regjistr elektronik të rekordeve të studentëve por edhe në hard copy. Gjatë vizitës në IAL u inspektuan në mënyrë rastësore disa dosje studentësh dhe rezultuan në rregull.</p> |
| <p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikën e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p> | <p>Universiteti i New York në Tiranë, nëpërmjet Zyrës së Karrierës mban të dhëna të përditësuara, bazuar në kontaktin e vazhdueshëm me studentët, në lidhje me studentët e punësuar pas përfundimit të këtij programi studimi. (Tabela 11.1 në Aneks)</p> <p>Një rol të rëndësishëm në mbajtjen e statistikave të punësimit ka dhe Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të marrë mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në Europë e më gjerë.</p> |
| <p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p> | |
| <p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p> | <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se që në momentin e interesimit dhe më pas të regjistrimit dhe në vijimësi studentët informohen për programin e studimit. Informacioni i nevojshëm ndodhet në faqen e internetit të universitetit, u dërgohet elektronikisht përmes adresave elektronike që u jepen studentëve që në regjistrim, ofrohet nga personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ si edhe shpallet në tabelat e njoftimeve.</p> <p>Që në fillim të çdo moduli, studentët njihen me strukturën e tij se dhe me mënyrat e vlerësimit. Pas çdo provimi, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve. (Aneks 20.4 RVB)</p> |
| <p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p> | |

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

Studentët e UNYT kanë mundësinë e këshillimit nga Fakulteti dhe nga zyra e karrierës dhe alumni. Kjo zyrë ka si qëllim të mbështesë dhe udhëheqë studentët në kërkim të vendit të tyre të ardhshëm të punës. (Aneks 20.3 RVB) Departamenti monitoron ecurinë individuale të studenteve, ndersa Zyra e Karrierës i këshillon për zhvillimin e tyre profesional. Kjo strukture punon për të realizuar këshillimin për karriere dhe për të mbajtur lidhjet e institucionit me të diplomuarit.

Praktikat mesimore konsiderohen vecori e këtij institucioni dhe konsiderohen si një nga elementet e rëndësishme të programit të studimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

Në përputhje me kriteret ligjore në fuqi, studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve Master Shkencor në UNYT. UNYT ka vendosur nivelin B1/B2 të anglishtes si kriter pranues por jo përjashtues. Institucioni informon studentët në lidhje me statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron, si dhe me politikën e punësimit.

Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve.

GVJ konstatoi se UNYT disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar.

Cilesia e studenteve në hyrje të këtij programi studimesh është mesatar, 7.5-8 notë hyrëse, megjithatë nota e studentëve ka një rritje progresive gjatë viteve të shkollës.

Norma e punësimit të studentëve të këtij programi studimesh është 100%.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Bazuar në dokumentat strategjike, UNYT synon të mbështesë kërkimin shkencor ndërdisiplinor dhe nderinstitucional në mes të gjithë njesive baze, në partneritet me institucione të tjera kërkimore brenda dhe vecanerisht jashtë vendit.

Në lidhje me kërkimin shkencor, bazuar në dokumentat strategjike qofte ato të përgjithshme si strategjia e institucionit apo dokumentat e perditesuara 2018-2022, theksojnë se kërkimi shkencor do të përbejë një nder shtyllat kryesore të orientimeve strategjike të ardhshme, si dhe një nder drejtimet kryesore të orientimit të fondeve dhe dhenies së vemendjes së duhur. UNYT po mundohet të rrisë kapacitetet e veta infrastrukturore në drejtim të rritjes dhe përthithjes së aftësive kërkimore. Kështu që, krahas rritjes dhe inkurajimit të stafit drejt publikimit të botimeve me të mira, UNYT po synon rritjen e efektivitetit të kërkimit shkencor përmes instalimit të njesive të reja kërkimore dhe riorganizimit të strukturave perkatese kërkimore, inovative, të projekteve apo ato të marrëdhënieve nderkombetare, duke u munduar të japë vemendjen e duhur në të ardhmen në secilin prej tyre.

GVJ konstaton se institucioni është mbështetur tek Strategjia e Kërkimit 2014-2017, si dhe dokumenti i planit strategjik 2018-2022 për të prioritetizuar objektivat në lidhje me kërkimin, për të organizuar dhe vëzhguar kërkimin shkencor dhe rezultatet e tij. Si rezultat i politikës së organizuar të institucionit, nëpërmjet të cilës UNYT ka investuar në fundmi në rritjen e kapaciteteve, burimeve dhe zhvillimin cilësor të metodologjive të kërkimit, si rezultat i së cilës, pjesa e stafit e angazhuar në kërkim është rritur.

Nga krahasimi i nje plani buxheti kerkimi dhe zhvillimi akademik per dy vitet 2016-2017 dhe 2017 2018, vihet re se:

- Ka nje rritje ne totalin e buxhetit te kerkimit nga 20.000 ne 25.0000;
- Rritja eshte ne theksim te pjesemarrjes dhe nxitjes per ne konferenca shkencore krahasuar me pandryshuaeshmerine ne zera te tjere si projekte kerkimore, publikime shkencore, dhe organizim vjetor te konferencave.

GVJ konsideron perparësi mbështetjen e kërimit shkencor ndërdisiplinor mes të gjithë njësive bazë, departamenteve e qendrave kërkimore, dhe në partneritet me institucione të tjera kërkimore. UNYT ka përcaktuar fushat prioritare kërkimore mbështetur tek profili i institucionit, interesave kërkimore të stafit sikurse edhe prioriteteve kërkimore të tregut European të kërimit.

Nga takimet në institucion, por edhe bazuar në dokumentacion rezulton se në lidhje me aktivitetet e organizuara nga njësia, vetë stafi dhe drejtuesit ndjejnë nevojën e kërimit në thellësi, më të orientuar drejt departamentit në formën e tryezave të rumbullakëta apo aktiviteteve të profilizuara shkencore të cilat mungojnë, apo një qasje më aktive ndaj përfshirjes së biznesit në to, apo nevojën për analiza të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë shqiptare, etj.

Njësia organizon edhe seminare zhvilluese, kryesisht me qëllim nxitjen e zhvillimit të personelit më të ri akademik, sidomos në drejtim të përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Gjithashtu njësia mbështet stafin akademik me eksperiencë të hartojë plane individuale të kërimit shkencor. Ndonëse kërkiti është individual, UNYT përpiket që t'a institucionalizojë atë. Krijimi brenda UNYT i një organizate jo fitimprurëse (non-profit) ka mundësuar aplikimin në projekte, gjë e cila ka dhënë rezultate, dhe se fundmi është instaluar nje zyre e projekteve dhe e inovacionit e cila megjithese ka shume pak kohe qe eshte krijuar ka filluar te orientoje me qarte kerkimin si objektiv strategjik.

UNYT ka bere perpjekje per te marre pjese ne projekte te ndryshme nderkombetare si Jean Monnet apo Erasmus, ka organizuar konferenca nderkombetare dhe nje kombetare, por nuk ka zhvilluar se fundmi nje Konferenca qe te perputhet me kete program studimi (konferenca e fundit ka qene ne 2015). Zyra e projekteve dhe e inovacionit ka vijuar se fundmi aktivitetin e saj me krijimin e nje database, pra me procesin e informimit. Kjo qender ushtron funksione bazike, ate te selektimit te projekteve dhe ofrimit tek fakultetet. Kjo zyre eshte realizuar ne funksion te objektiveve strategjike te vendosur 2018 - 2022. Nga ana tjeter, hartohen plane vjetore individuale akademike te shoqeruar me plan buxheti nga pedagoget me tematika e buxhetin qe mund te organizohet. Pra ka liri akademike per te propozuar organizimin e konferencave, dhe tematikat hartohen nga brenda departamenteve.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 13 ne aneks)

Ky program studimi si te gjitha programet e tjera brenda UNYT, synon te mbuloje dhe permbushe nevojat qe ka apo mund te kete tregu shqiptar, rrjedhimisht dhe me studime te studenteve, stafit, konferenca, tryeza te rumbullakteta per tematika dhe problematika te finances dhe kontabilitetit. Kjo do te thote qe rrjedhimisht nevoja per aktivitete kerkimore, seminare e konferenca kombetare apo lokale eshte e madhe, prandaj sugjerohet qe ky program studimi te mbeshtese vecanerisht me konferenca te tilla kombetare, te organizuara, shperndarara dhe planifikuara ne kohe si dhe gjithperfishirese (staf, student). Perqendrimi ne formate te ndryshme kerkimi perben oportunitet si per stafin, institucionin ashtu edhe per studentet, dhe ne nivele afatmesme rrit cilesine e mesimdhënies dhe mensimnxënies duke prodhuar studnete me njohuri te forcuara dhe qendrushme per tregun shqiptar. Te dhenat e reflektuara edhe ne tabelen 13 ne aneks tregojne se stafi akademik i ketij programi studimi ben perpjekje te vazhduara per te qene i perfishire ne programe kerkimi, por sugjerohet te shtrhet ne kohe. Kjo do te thote qe aktivitetet kerkimore si psh konferencat te jene te planifikuara dhe te zhvillohen pergjate viteve te

shperndara ne vite apo periudha me te shkurtra kohe, ne kete menyra shperndahen edhe kapacitetet e stafit njetrajtshmerisht.

Bashkepunimi intensiv me nderkombetare nuk ka prodhuar konferenca apo aktivitete shkencore vitet e fundit. Kjo ne me se shumti eshte justifikuar me numrin e vogel te stafit, intensitet akreditimesh, riorganizimi dhe drejtimie e ri, hapjen e doktoraturave, akreditimin e programeve shqip kane penguar vitet e fundit perqendrimin ne ate cka duhet te beje vertet nje universitet: kerkimin shkencor. E gjitha kjo ka bere qe kerkimi shkencor si funksion vital dhe mjaft i rendesishem per nje universitet te perbeje nje pike te dobet. Persa kohe qe plani i ri strategjik 2018 - 2022 vendos objektivin primar zgjerimin dhe mbeshtetjen e kerkimit shkencor dhe outputeve te tij, sikurse pasja e nje zyre te posacme kerkimi, kjo tashme perben nje mundesi/shans te mire per te rritur kapacitetet kerkuese, justifikuar dhe mbeshtetur rritjen e buxhetit per kerkimin, si dhe perfshire me shume stafet dhe studentet ne jetezimin e kesaj njesie. Doktoraturat konsiderohen si shans/mundesi per te ardhmen e kerkimit shkencor, dhe shihen si shans i mire per universitetin, si dhe nje mundesi per te krijuar nje strukture me teper ne mbeshtetje te kerkimit shkencor.

Dokumentacioni perkatës i marrë në vizitat në institucion

- Plani strategjik UNYT 2013 2017, dhe 2018 2022
- Strategjia e kerkimit shkencor te UNYT 2014 2017
- Produktet e kerkimit shkencor 2012-2018
- Pjesemarrja ne projekte - UNYT

GVJ konsideron perparësi mbështetjen e kerkimit shkencor ndërdisiplinor mes të gjithë njësive bazë, departamenteve e qendrave kërkimore dhe në partneritet me institucione të tjera kërkimore. UNYT ka përcaktuar fushat prioritare kërkimore mbështetur tek profili i institucionit, interesave kërkimore të stafit sikurse edhe prioriteteve kërkimore të tregut European të kerkimit.

Institucioni ka ndermare takime me drejtues dhe CEO te ndryshem te kompanive te rendesishme dhe i ka kontaktuar ato per nevojat e veta, por kjo nuk perben kerkim tregu per te mbeshtetur programin, pra nuk eshte i mjaftueshem si kerkim. Nje kerkim i mirefillte do te percaktoje nese tregu shqiptar, bizneset vendase orientojne nevojat e tyre drejt masterave shkencore apo profesionale, drejt masterave kontabilitet apo te degeve te tjera.

Rekomandohet te hartohet nje kerkim i mirefillte tregu, mbi bazat e se ciles te vendosen vertet orientimi mbi ato profile apo dege qe i kerkon tregu shqiptar dhe nevojat e biznesit vendas. Ne kete menyre vete UNYT do te jete i fokusuar ne zhvillimin e konferencave kombetare te perqendruar ne ato sektore qe nga studimi i tregut rezultojne qe kane nevojte per me shume studime dhe mbeshtetje kerkimore. Nje kerkim i mirefillte tregu do te perafroje shume me mire orintimet nderkombetare me nevojat kombetare. Ekziston nje strategji qe mundohet te orientoje kerkimin (market research policy 2017) i cili vertet perben nje dokument mjaft cilesor dhe te rendesishem per institucionin, shume referues, por nuk perben nje dokument kerkimi tregu, eshte shume me teper nje analize konkurrenciale. Rekomandohet fuqishem qe mbi kete dokument dhe ne vijemesi te tij te vazhdohet me tej, dhe mbi bazen e tij te ndertohet kerkimi i tregut.

Rekomandohet nje shperndarje dhe planifikim i rregullt i konferencave nderkombetare. Sugjerohet ndertimi i nje plani periodik i zhvillimit te aktiviteteve shkencore sipas nje plani te pakten 2 vjecar ne te cilin te shperndahen ne kohe dhe njesi orgaizative aktivitete shkencore si: konferenca nderkombetare, seminare dhe ëorkshope rajonale, aktivitetete shkencore nderdisiplinore midis njesive baze brenda UNYT, konferenca kombetare. Keto te shpallen ne rjetet e publikimeve online dhe te ftohen pedagoget qe te shperndajne mundesiste e tyre kerkimore ne secilen prej tyre. Duke u planifikuar me pare integrohen ne menyre efektive mundesite edhe potencialet kerkimore te UNYT.

Rekomandohet nje fokusim me intensive tek aktivitetet kombetare shkencore, tek ato sektore dhe fusha qe kane rendesi strategjike per ekonomine shqiptare dhe rajonale.

Imazhi dhe emri i mirë në treg i institucionit bëjnë të mundur dhe ofrojnë një bazë të qëndrueshme për mbështetjen nga projekte që forcojnë kërkimin, përmirësojnë mësimdhënien dhe i shërbejnë ekonomisë shqiptare. Rekomandohet përfshirje më e madhe cilësore dhe sasiore e studentëve të masterit në kërkim, jo vetëm me detyrat e tyre, projektet e kursit por me orientime dhe qasje më të forta drejt bashkëbërjes së projekteve/detyrave me stafet akademike në shërbim të tregut, duke bërë të mundur në këtë mënyrë lidhjen e kërkimit me mësimin.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve. | |
| <p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p> | <p>Bazuar në konsultimet me dokumentacionin e vene në dispozicion si dhe me takimet në terren, GVJ gjykon se ka një përparim për të institucionalizuar kërkimin shkencor brenda UNYT, si përmes dokumentave strategjike (strategjia e 2018-2022) ashtu edhe përmes hapjes apo ngritjes së strukturave të vecanta që mbështesin kërkimin, si psh zyra e projekteve dhe e inovacionit në 2017, etj. Gjithashtu ka një rritje dhe vlerësim në buxhetin për kërkimin, si dhe një prioritet për të nxitur stafet drejt publikimeve dhe mbështetjes financiare të tyre. Megjithatë ndihmesa që mund të japë stafi akademik i UNYT në mbështetje të ekonomisë vendase mund të jetë shumë here me i madh, pavarësisht se është staf i vogël. Këtë mund ta bëjë përmes fokusimit në konferenca dhe aktivitete kombëtare (pra të nxitën kryerja e me shumë aktiv shkencore komb), rritjes së bashkëpunimeve me të njëjtat me të gjera biznesesh vendase, zgjerimit të networkut me NGO institucionale dhe biznese shqiptare, nxitjes së bizneseve apo NGO vendase dhe të huaja për të bërë aktivitete me karakter kombëtar brenda apo në bashkëpunim me UNYT.</p> |
| Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar. | |
| <p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p> | <p>Personeli akademik është kryesisht i arsimuar në vende ndërkombëtare por edhe ajo pjesë e stafit që ka formim kombëtar në arsimim zotëron mjaft mirë anglishten, dhe ka përvojë në mesimdhënie.</p> |
| Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p> | <p>Krahas përfshirjes së stafëve akademike në seminare të brendshme apo aktivitete të tjera që zhvillon UNYT, GVJ gjykon dhe sugjeron një përfshirje më të madhe jo vetëm të stafit akademik por edhe atij administrativ në projektet dhe thirrjet Erasmus, për të rritur eksperiencat dhe aftësitë e tyre sipas fushave. Institucioni ka dokumenta që mbështesin rritjen akademike si politika e promovimit të stafit, apo vlerësimet që bëjnë zyrat e sigurimit të cilësive krahas rritjes së niveleve të mesimdhënies mbështesin edhe rritjen akademike të tyre në drejtim të kërkimit. GVJ gjykon se përmbushjen e këtij standarti do</p> |

ta mbeshteste edhe ulja e numrit te lendeve per cdo semester sepse do te krijonte kushte dhe kohe per te rritur edhe kerkimin.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Institucioni disponon ne menyre periodike raportime vjetore te te gjithë aktivitetit ne lidhje me mesimdhenien, kerkimin, si dhe publikon listene e stafit me publikimet e fundit te kryera nga ato.

Por, qofte nga takimet ne terren ashtu ehde nga dokumentacioni pranohet dhe vihet re nje mungese e aktiviteve shkencore si konferenca kombetare per te patur nje qasje me te madhe te UNYT me tregun shqiptar dhe nevojat e tij per kerkim dhe mbeshtetje shkencore.

UNYT disponon mundesi te mira per te orintuar kete ne te ardhmen, persa kohe qe plani i ri strategjik 2018 - 2022 vendos objektivin primar zgjerimin dhe mbeshtetjen e kerkimit shkencor dhe outputeve te tij, kjo tashme perben nje mundesi/shans te mire per te rritur kapacitetet kerkuese, justifikuar dhe mbeshtetur rritjen e buxhetit per kerkimin, si dhe perfshire me shume stafet dhe studentet ne jetezimin e kesaj njesie. Doktoraturat konsiderohen si shans/mundesi per te ardhmen e kerkimit shkencor, dhe shihen si shans i mire per universitetin, si dhe nje mundesi per te krijuar nje strukture me teper ne mbeshtetje te kerkimit shkencor.

Gjithashtu kumtesat dhe dokumentat e prodhuara apo rezultuara nga aktivitetet kombetare shkencore do te sherbejne si burim referues ne te ardhmen edhe per studentet.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ, jep rekomandimet e mëposhtëme:

- Ka nje perpjekje te konsiderueshme per te institucionalizuar kerkimin shkencor brenda UNYT, si permes dokumentave strategjike (strategjia e 2018-2022) ashtu edhe permes hapjes apo ngritjes se strukturave te vecanta qe mbeshtesin kerkimin, si psh zyra e projekteve dhe e inovacionit ne 2017, etj. Gjithashtu ka nje rritje dhe vleresim ne buxhetin per kerkimin (fondet e kerkimit perbejne 14% te vleres se buxhetit vjetor te UNYT), si dhe nje prirje per te nxitur stafet drejt publikimeve dhe mbeshtetjes financiare te tyre. Megjithate ndihmesa qe mund te jape stafi akademik i UNYT ne mbeshtetje te ekonomise vendase mund te jete shume here me i madh, pavaresisht se eshte staf i vogel. Kete mund ta beje permes fokusimit ne konferenca dhe aktivite kombetare (pra te nxiten kryerjja e me shume aktiviteve shkencore kombetare), rritjes se bashkepunimeve me te nje rrjet me te gjere biznesesh vendase, zgjerimit te neteorkut me NGO institucionale dhe biznese shqiptare, nxitjes se bizneseve apo NGO vendase dhe te huaja per te bere aktivite me karakter kombetar brenda apo ne bashkepunim me UNYT.
- Duhet te rriten kapacitetet ne burimet njerezore (staf akademik dhe staf administrativ) per te shkruar projekte, te perfshihen dhe motivohen edhe stafi akademik ne shkrimin e projekteve, pasi psh vetem 4% e te ardhurave vjen nga kerkimi.
- Qendra kerkimore per ekonomine si nje nder 3 qendrat ekzistuese brenda UNYT (per ekonomine,

social sciences dhe kompjuter sciences), duhet te kete funksion nderdisiplinor, te integroje potencialet akademike, studentet, stafin administrative per teje projekteve dhe konferencave.

- Rekomandohet nje fokusim me intensive edhe tek aktivitetet kombetare shkencore, tek ato sektore dhe fusha qe kane rendesi strategjike per ekonomine shqiptare dhe rajonale, ne kete menyre fokusimi ne kete ze se bashku me rekomandimin per kryrjen e nje studimi te mirefillte tregu do te optimizojne perdorimin e burimeve te UNYT drejt mbulimit te nevojave qe ka tregu vendas me programe studimi si dhe do t'i sherbejne me shume ekonomise vendase duke kryer ne kete menyre misionin fisnik qe ka cdo IAL, ate te mbeshtetjes se ekonomise dhe zhvillimit vendas.
- Sugjerohet qe te shperndahet buxheti i kerkimit ne mjaft zera.

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Piesa përshkrimore

UNYT ka nje vemendje te kahershme ndaj faktorit nderkombetar, dhe kjo ka perbere nder avantazhet kryesore ne perzgjedhjen nga studentet te ketij universiteti si dhe perben nje pike te forte per te. Kete vemendje tashme e ka institucionalizuar edhe permes strategjise 2016-2021 te nderkombetarizimit ku zyrtarizohen dhe i behen me dije publikut te gjere se cilat jane prioritetet kryesore ne drejtim te rritjes dhe nderkombetarizimit.

Strategjite e nderkombetarizimit kane te specifikuar qellimet dhe objektivat perkatese ne drejtim te nderkombetarizimit. Nderkohe qe organizohen edhe aktivite dhe diskutime te brendshme te institucionit qe nxisin mendimin dhe kerkimin shkencor etj.

GVJ konstaton se: Qasja ndaj kerkimit, mesimdhënies, rezultojne dhe rrjedhojne ne nje përafrim të mundshëm të reflektuar në marrëdhëniet kombëtare dhe ato ndërkombëtare. Institucioni ka dhe nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet aktiviteve të vazhdueshme informuese dhe shkëmbimit të informacionit si pjesëmarrja në aktivite dhe konferenca shkencore në forume ndërkombëtare dhe kombëtare. Zyra e Karrierës mban lidhje me komunitetin e biznesit, i cili është aktiv veçanërisht në panairin e përvitshëm të punësimit që UNYT organizon. Një pjesë e madhe e stafit akademik të UNYT të angazhuar në programin e studimit "Master i shkencave" në "Financë dhe kontabilitet" është trajnuar ndërkombëtarisht. Nevojat në fusha të ekspertizës të cilat nuk janë të mbuluara nga stafi me kohë të plotë i UNYT- mbulohen nga profesorët vizitues/ part time. Nga dokumentacioni por edhe nga vizita në institucion, dhe takimet me drejtues të fakultetit dhe veçanërisht të qendrës kërkimore vihet re se roli që kjo qendër mund të luajë në nxitjen e kerkimit shkencor, në forcimin e lidhjeve me bizneset/NGO/institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare, pra në rritëzimin e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimeve, është më i madh se sa ai aktual. Vihet re se infrastruktura në shërbim të kerkimit shkencor është mjaft e mirë dhe mbështetëse për punë individuale, por duhet të ketë politika që të tërheqi sa më shumë staf dhe studentë drejt përdorimit të tyre. Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit është pasiv. Studentët dhe stafi duhet të jenë pjesë aktive e përpilimit të planit të punës/aktiviteve që mund dhe duhet të mbështesë kjo qendër. Po kështu, edhe qendra e karrierës ka një rol të rëndësishëm këshillues me studentët, mbështet internshipin, përditëson databazën e bizneseve si dhe orienton drejt forcimit të punës me alumni.

Zyra e karrieres ka nje rendesi vitale dhe synon ne te ardhmen te forcoje lidhjet me studentet. Gjithsesi per t'a bere me eficence dhe perfituese per studentet do te ishte mire dhe sugjerohet edhe nga drejtuesit e ketyre njesive ardhjen dhe mbajtjen e kontakteve te studenteve me zyren e karrieres. UNYT duhet te gjej menyra per te qene ne mbeshtetje te studenteve. P.sh. brenda lende se intershipit si e vetmja lende qe

orienton studentet drejt tregut te punes do te ishte mire qe te shtohen instrumentat qe motivojne studentet dhe i cojne ata drejt zyres se karrieres.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 14 në Aneks)

Gjykimi mbi plotësimin e këtij standarti është i plotë dhe i konsiderueshëm, përveçse tregohet se një strategji e vecante nderkombetarizimi ka fokusuar nderkombetarizimin e UNYT por edhe zyra e mardhenieve nderkombetare mundohet të jetë aktive, gjithëpërfshirëse dhe kritike për punën e saj si dhe atë çka mund të epermiresojë dhe si në të ardhmen. UNYT përmes strukturave të veta, së fundmi edhe përmes zyres së mardhenieve nderkombetare të krijuar në vitin 2017 mundohet të vendosë ura bashkëpunimi me institucionet kombetare dhe nderkombetare dhe t'i fuqizojë ato ndër vite përmes aktiviteteve të ndryshme të kryera edhe brenda UNYT. Këto vendime ndaj bashkëpunimeve nderkombetare dhe kombetare, UNYT e ka institucionalizuar edhe përmes dokumentave strategjike, si p.sh., plani strategjik 2018-2022, objektivi strategjik 4 ku UNYT synon të rrisë praninë e kultures nderkombetare edhe përmes zgjerimit të marrëveshjeve dhe aleancave strategjike me universitete dhe institucione nderkombetare të kerkimit, ndërsa në qëllimin strategjik nr 6 specifikohet si qëllim strategjik: "mbajtja dhe zgjerimi i një rrjeti marrëdhëniesh dhe partnershipi".

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 14 në aneks)

Lidhjet me tregun e punës janë të përqendruara mjaftueshëm në organizimin e përvitshëm të panairit, por shumë mire dhe eficient do të ishte zgjerimi i rrjetit të bizneseve vendase që marrin pjesë në panair (mund të referohen tek degët e tatimit taksave me perditësimet dhe hyrjet e reja të bizneseve), diversifikimi i tyre, si dhe zgjerimi i aktiviteteve me biznesin vendas.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion. Bashkëpunimi i UNYT është institucionalizuar përmes memorandumeve të bashkëpunimit, me institucione akademike dhe jo akademike.

Qasja e re proaktive ndaj institucioneve europiane përben një shans të mirë për të ardhmen. Në lidhje me bashkëpunimet vihet re një ndjeshmëri dhe përafrim ndaj qasjes europiane e cilitar kjo edhe në objektivat strategjike, por edhe në veprimet konkrete dhe marrëveshjet e bashkëpunimit. Marrëveshja me Universitetin e Greenëtit apo përpjekja për të bashkëpunuar me universitetin e Tuluzës në Francë demonstron një përpjekje për diversifikim dhe hapje në tregje të bashkëpunimeve të reja. Pavarësisht se këto përpjekje nuk lidhen direkt me këto programe studimi por me programe të reja, ky fokus i ri i zgjerimit dhe i diversifikimit të niveleve të studimit të ofruara do të shërbejë si bazë për të forcuar dhe ratifikuar dhe programet e tjera dhe nuk përben në fakt konflikt me orientimin e kahershëm amerikan.

Strategjia e nderkombetarizimit forcon dokumentimin e fokusimit ndaj qasjes europiane, dhe ka të bëjë me nderkombetarizimin e këtij profili diplome, për të shtuar vlerën dhe rëndësinë e kësaj diplome jo vetëm në tregun shqiptar por edhe atë nderkombëtar. Kjo strategji shkon përtej ofrimit të diplomës duale. Përkrahje e suport për të mbështetur këto ka edhe zyra e bashkëpunimit me jashtë.

Së fundmi është shkruar një marrëveshje me dhomen turke të tregtisë që do të hapë dritare të reja bashkëpunimi, por sugjerohet që të synohet të zgjerohet kjo nisje duke e shtrirë këtë marrëveshje bashkëpunimi edhe me dhomat e tjera të tregtisë që janë në vend. Kjo gjë do të lehtësonte funksionimin e strukturave brenda UNYT, do të zgjeronte dhe rriste numrin e marrëveshjeve që do të perktehen direkt në rritje të punësuarve dhe mobilitete.

Vlerësimi sipas Standardeve

| Standardi/Kriteret | Vlerësimi sipas standardeve |
|---|---|
| Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij. | |
| <p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p> | <p>N. A.</p> <p>UNYT për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira nga ana e studentit. UNYT duhet të rrise me teper netëorkun e vet edhe me biznese dhe organizata kombetare krahas forcimit të marrëdhënieve ndërkombetare.</p> |
| Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p> | <p>GVJ gjykon se UNY, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit; si dhe nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p> <p>Gjykimi nga vizitat në institucion është se stafi i vogël me kohe të plote është mjaft i angazhuar në men shume detyra se sa mesimdhenia, shkojnë përtej komunikimeve me studentet, përgatitjen e raporteve të ndryshme që nga me të thjeshtat tek ato të akreditimit.</p> |
| Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj. | |
| <p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p> | <p>GVJ konstaton gjithashtu se UNYT ka vendosur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me institucione partnere të huaja dhe vendase. Nga dokumentacioni por edhe nga vizita në institucion, dhe takimet me drejtues të fakultetit dhe veçanërisht të zyrës së karrierës vihet re se roli që kjo zyre luan është relativisht i rëndësishëm, koherent dhe i qëndrueshëm në kohe, në forcimin e lidhjeve me bizneset/NGO/institucionet lokale, kombëtare, dhe ndërkombëtare, pra në rritjen e marrëdhënieve dhe të bashkëpunimeve.</p> <p>Studentët do të synonin më shumë internshipe në të ardhmen, por edhe biznesi duhet të jetë më shumë i orientuar sipas nevojave/sectorëve prioritarë të vendit, ku institucioni të ofrojë mbështetjen e vet.</p> <p>UNYT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me komunitetin e biznesit me të cilat garanton trajnimin dhe konsolidimin e aftësive praktike të studentëve të</p> |

tij. Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit duhet të jetë me aktiv.

UNYT ka organizuar takime dhe prezantime të menaxherëve të praktikës me studentët e programit, si dhe ka organizuar vizita të studentëve në qendra të ndryshme të biznesit.

UNYT i ka vlerësuar si të dobishme vendosjen e marrëdhënieve me institucionet partnere dhe ato të biznesit dhe i sugjerohen berja e raporteve periodike që përfshijnë një analizë të posaçme dhe raport analitik të përfitimeve nga ky bashkëpunim.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ konkludon se në drejtim të bashkëpunimit kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhënieve me publikun vihet re një përmirësim dhe zhvillim të reja të dokumentuara në planet strategjike të së ardhmes duke përbërë mundësi të reja për UNYT.

Qasja e re proaktive ndaj institucioneve europiane apo hapja e zyrave për marrëdhëniet ndërkombëtare në 2017 përbejnë një shans të mirë për të ardhmen.

Sugjerohet rritje e bashkëpunimit me institucione kombëtare përmes konferencave dhe aktiviteteve të tjera me fokus zhvillimin e ekonomisë shqiptare, përse kohe që misioni i cdo IAL është edhe dhenia e kontributit në rritjen ekonomike të vendit. Sugjerohet berja e analizave të rregullta vjetore mbi bashkëpunimet me bizneset vendase dhe numrin e të punësuarve, përditësimi i listës së bizneseve dhe NGO dhe përfshirja e tyre në cdo plan do të rrisë mundësitë dhe efikasitetin për të ardhmen.

Të punohet me shumë për përthithjen e mobiliteteve përmes Erasmusit apo programeve të tjera si për stafin akademik ashtu edhe atë administrativ, sepse janë mundësi të mira për të çuar më tej këtë program studimi. GVL gjykon se ndërkombëtarizimi i UNYT ka qenë i kënaqshëm në kontekstin e këtij programi studimi.

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

| | Pikat përmbledhëse nga akreditimi i parë | Statusi aktual |
|---|---|-----------------------|
| 1 | Të bëhet më shumë përpjekje për të rritur numrin e studentëve në këtë program studimesh | Reflektuar |
| 2 | Të krijohen terrene sportive | Reflektuar |
| 3 | Të përmirësohet kontigjenti i studentëve | Reflektuar pjesërisht |
| 4 | Të shihet mundësia për uljen e tarifës së studimit për këtë program studimi | Reflektuar |

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. Pasja e një plani strategjik 2018-2022, misioni dhe objektiva të qarta të vendosura nga IAL.
2. Stabiliteti, eksperiencia dhe kualifikimi i stafit akademik.
3. Disponibiliteti i një infrastrukture moderne.
4. Fokusi mbi përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.
5. Normë punësimi shumë e lartë e programit të studimit.

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa e një studimi të mirëfilltë tregu.
2. Niveli i ulët i aktiviteteve në kuadër të kërkimit shkencor, psh. konferencave shkencore.
3. Ngarkesë shumë e lartë e stafit akademik efektiv (PAE) në terma të orëve dhe kurseve të mbuluara gjatë një viti mësimor.

c. Mundësitë:

1. Bashkëpunime të reja me aktorë brenda dhe jashtë vendit, për rritjen e reputacionit të programit dhe njohjen lokale dhe ndërkombëtare.
2. Interesimi në rritje i kompanive private dhe organizatave publike, për të rekrutuar studentët cilësorë.
3. Marëveshjet e shumta me bizneset dhe bankat për realizimin e praktikave mësimore dhe mundësi punësimi për studentët.

d. Pengesat:

1. Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor, krijojnë problem në përshtatjen e institucioneve arsimore.
2. Tranzicioni i tejzgjatur i ekonomisë shqiptare çon në krijimin e një mjedisi jo shumë të qëndrueshëm dhe transparent.
3. Konkurrenca e lartë; programi i studimit “Master i shkencave” në “Financë dhe kontabilitet”, ofrohet nga shumë konkurrentë, IAL publike dhe private.

Rekomandime:

- a. Lidhur me ngarkesën e stafit në terma të orëve të zhvilluara, Rekomandohet që të reduktohet ngarkesa në orë dhe kurse e stafit akademik efektiv.
- b. Në lidhje me tregun e punës, GVJ gjykon se vijueshmëria dhe suksesi i këtij programi lidhen patjetër dhe me *nevojën e ndërmarrjes së një studimi tregu*, i cili nuk mbetet thjesht me diskutime midis CEO-ve apo drejtuesve të organizatave kombëtare, për të kuptuar vërtet nëse ka nevojë tregu shqiptar për diploma dhe programe të tilla, por edhe për të mirëpërdorur fuqitë dhe burimet që ka UNYT në ato drejtime që i shërbejnë më së mire ekonomisë shqiptare në rradhë të parë, për të optimizuar së pari misionin e saj si IAL: për t'i shërbyer vendit. Pra, për këtë program studimi, në të ardhmen UNYT duhet të ndërmarrë një studim tregu që të sigurojë vërtet nevojën e tregut shqiptar për pasjen e këtij programi studimi. Institucioni ka ndërmarrë takime me drejtues dhe CEO të ndryshëm të kompanive të rëndësishme dhe i ka kontaktuar ato për nevojat e veta, por kjo nuk përbën kërkim tregu për të mbështetur programin, pra nuk është i mjaftueshëm si kërkim. Një kërkim i mirëfilltë do të përcaktojë nëse tregu shqiptar, bizneset vendase orientojnë nevojat e tyre drejt masterave shkencorë apo profesionalë, drejt masterave kontabilitet apo të degëve të tjera. Rekomandohet të hartohet një kërkim i mirëfilltë tregu, mbi bazat e së cilës të vendosen vërtet orientimi mbi ato profile apo degë që i kërkon tregu shqiptar dhe nevojat e biznesit vendas. Në këtë mënyrë vetë UNYT do të jetë i fokusuar në zhvillimin e konferencave kombëtare të përqëndruar në ato sektorë që nga studimi i tregut rezultojnë që kanë nevojë për më shumë studime dhe mbështetje kërkimore.
- c. Sugjerohen më shumë aktivitete shkencore dhe veçanërisht konferenca për çështje që i përkasin vendit, kjo do të sjellë përputhje më të mirë me strategjinë 2018-2022 si dhe do i shërbente më shumë misionit të UNYT. Aktualisht bashkëpunimi intensiv me ndërkombëtarë nuk ka prodhuar konferenca apo aktivitete shkencore vitet e fundit.
- d. Rekomandohet që UNYT të përpiqet të gjenerojë fonde edhe nga burime të tjera dhe jo vetëm nga tarifat e studentëve
- e. Lidhjet me tregun e punës janë të përqëndruara mjaftueshëm në organizimin e përvitshëm të panairit, por shume mirë dhe eficient do të ishte zgjerimi i rrjetit të bizneseve vendase që marrin pjesë në panair (mund të referohen tek degët e tatim taksave me përditësimet dhe hyrjet e reja të bizneseve), diversifikimi i tyre, si dhe zgjerimi i aktiviteteve me biznesin vendas.
- f. Sugjerohet rritje e bashkëpunimit me institucione kombëtare përmes konferencave dhe aktiviteteve të tjera me fokus zhvillimin e ekonomisë shqiptare, përse kohë që misioni i çdo IAL është edhe dhënia e kontributit në rritjen ekonomike të vendit. Sugjerohet bërja e analizave të rregullta vjetore mbi bashkëpunimet me bizneset vendase dhe numrin e të punësuarve, përditësimi i listës së bizneseve dhe NGO dhe përfshirja e tyre në çdo panair do të rrisë mundësitë dhe eficientësinë për të ardhmen.

- g. Të punohet më shumë për përthithjen e mobiliteteve përmes programeve ERASMUS apo programeve të tjera si për stafin akademik ashtu edhe atë administrativ, sepse janë mundësi të mira për të çuar më tej këtë program studimi.
- h. GVJ gjykon së ndërkombëtarizimi i UNYT ka qënë i kënaqshëm në kontekstin e këtij programi studimi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Prof.Dr. Klodiana Gorica
2. Prof.Asoc.Dr. Ana Kapaj

SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

I. SUMMARY ANALYSIS OF FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

The institution has received some recommendations from the first accreditation of the program "Master of Science" in "Finance and accounting". Based on these recommendations, HEI has worked continuously on their fulfillment. From the entirety of the recommendations left by the first accreditation process, and from what the external evaluation group, found during the visit in institution and the provided documentation, it is concluded that:

| | Recommendations from first accreditation | Actual status |
|---|---|----------------------|
| 1 | More effort should be done to increase the student's number in this study program | Reflected |
| 2 | Create sport facilities for students | Reflected |
| 3 | Improve student quality | Partly reflected |
| 4 | To reduce the study fee for this study program | Reflected |

II. SUMMARY ANALYSIS OF THE RVJ BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES- OPPORTUNITIES, THREATS).

a. Strengths:

1. Having a Strategic Plan 2018-2022 with clear objectives and mission of HIE.
2. Stabilized, experienced and well qualified staff.
3. A modern infrastructure.
4. Continuous quality improvement.
5. High employment rate of the students.

b. Weaknesses:

1. Lack of proper market research for this study program.
2. Scientific research should be improved.
3. High overload of the effective academic staff in terms of teaching hours and courses.

c. Opportunities:

1. New collaborations with national and international actors to increase program reputation.
2. Increasing interest of private and public organizations, to recruit high quality students.
3. Numerous agreements with businesses and banks for teaching practices and employment opportunities for students.

d. Threats:

1. Frequent changes to the legal framework create problems in adapting higher education institutions.

2. The prolonged transition of the Albanian economy leads to the creation of a not very stable and transparent environment.
3. High competition in the Albanian HIE system.

Recommendations:

- a. It is recommended to reduce the effective academic staff loads in terms of teaching hours and courses taught.
- b. Regarding the labor market, the EET thinks that the continuity and success of this program is linked to the necessity of undertaking a market study. This study is not merely a discussion between CEOs or managers of national organizations, to understand the needs of Albanian market for such diplomas and programs, but also to use UNYT's strengths and resources in those directions that best serve the Albanian economy in the first place. So for this study program, in the future UNYT should undertake a market study to really understand the Albanian market needs for this study program. The institution has had meetings with various CEOs, but this is not a market research to support the program, so it is not enough. A proper market study will determine whether the Albanian labor market orient their needs towards scientific Masters in finance and accounting. *It is recommended to develop a proper market research*, on the basis of which the orientation of those profiles or branches demanded by the Albanian market and the needs of the local business are to be established. In this way, UNYT will be focused on the development of those sectors that from market research result in need for more research and research support.
- c. To serve better the mission to UNYT and to be more in line with the 2018-2022 strategy, organization of scientific activities, specifically conferences, on issues related to the country economy are suggested.
- d. It is recommended that UNYT should try to generate funds from other sources and not just from student fees.
- e. Labor market's links are sufficiently focused on the organization of the yearly fair. But it would be very good and efficient to expand the domestic business network that are participating in the labor fair, diversifying them, and expanding activities with the local business.
- f. It is suggested to increase the cooperation with national institutions through conferences and other activities focusing on the development of the Albanian economy, as long as the mission of the HEI is to contribute to the economic growth of the country. It is suggested to carry out regular annual analysis on cooperation with local businesses, updating the business list and NGOs and their inclusion in the labor fair will increase the opportunities and efficiency for the future.
- g. It is suggested to absorb more mobility through ERASMUS+ or other programs for both academic and administrative staff.
- h. UNYT's internationalization has been quite good in the context of this study program.

External Evaluation Group

1. Prof. Dr. Klodiana Goriea
2. Prof. Asoc. Dr. Ana Kapaj